



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Administrimit Aseteve të Qëndrueshme, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Nr. 609/9 Prot.

Tiranë, më 25/09/2016

V E N D I M

Nr. 115, Datë 25/09/2016

PËR

EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË KRYER NË ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME DIBËR "MBI PROCEDURËN E PRANIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË DOKUMENTACIONIT PËR REGJISTRIMIN FILLESTAR TË PASURIVE TË PALUAJTSHME DHE EVIDENTIMIN E TRAJTIMIN LIGJOR TË MBIVENDOSJEVE".

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "*Për auditimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë, për procedurën e pranimit dhe administrimit të dokumentacionit për regjistrimin fillestar të pasurive të pasurive të paluajtshme dhe evidentimin e trajtimit ligjor të mbivendosjeve*", të ushtruar në ZVRPP Dibër, për periudhën 01.01.2013 deri më 31.12.2015.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

Gjetje: 1. ZVRPP Dibër ka **141 Zona Kadastrale** nga të cilat **1 zk Qytet** dhe **140 zk në fshatra**. Janë futur në sistem **126 zk të fshatrave**, është në proces **1 zk 2932 Qytet** dhe nuk janë futur në sistem **14 zk të fshatrave** ose 10% ,tregues që shpreh nivel të ulët të përfshirjes

së zonave në sistemin e regjistrimit fillestar me ndikim në numrin e regjistrimeve të pasurive të paluajtshme,

- **administron rreth 18786 copë AMTP-të** nga të cilat: **201 copë në qytet dhe 16 815 AMTP** që i përkasin **126 fshatrave** në sistem; nga të cilat **për 3 fshatra të futura në sistem mungojnë e nuk administrohen fizikisht në arkive AMTP-të., përkatësisht (Begjunec zk.1134; Pilafe zk.2928, Rrashnapoje zk. 3135);**

ndërsa 1769 AMTP i përkasin 14 fshatrave të pa futura në sistem përkatësisht: (Bardhaj Rec zk.1111 me 77 AMTP, Dovolani zk. 1521 me 182 AMTP, Fushë e Vogël zk. 1662 me 105 AMTP, Fushë Kastrioti zk. 1663 me 28 AMTP, Hurdhe Rec zk.1973 me 51 AMTP, Kander zk. 2072 me 190 AMTP, Kishavec zk. 2153 me 275 AMTP, Kovashicë zk.2253 me 153 AMTP, Ndërshene zk.2774 me 41 AMTP, Pocest zk. 3004 me 154 AMTP, Qafë Murrë zk. 3080 me 165 AMTP, Sohodoll zk.3482 me 232 AMTP, Sohod i Vogël zk.3483 me 14 AMTP, Vasije zk.3717 me 102 AMTP; pasqyruar në tabelën emërtuar “Shtrirja e Zonave Kadastrale, Gjendja ne Sistem, Volumet, numri i KPP-ve dhe AMTP-ve, Pasuritë Bujqësore, Trojet dhe numri progresiv i Referencave të regjistrimeve në ZVRPP Dibër”, gjendje kjo në kundërshtim me kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me nenet 19,21,22 e vijim të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe me VKM nr. 556, datë 23.10.2000 “Për dorëzimin e dokumentacionit të pronave në ZVRPP” (Trajtuar në faqet 5-10 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 1: ZVRPP Dibër dhe ZQRPP Tiranë të marrin masa për fillimin, ndjekjen e procedurave dhe përcaktimin dhe mbështetjen me fondet përkatëse të nevojshme për përfshirjen në sistemin e menaxhimit të regjistrimit fillestar të 14 fshatrave zonave kadastrave me 1769 AMTP që përbëjnë 10% të Rrethit, si dhe të përfundojnë procesin e nisur të menaxhimit dhe Futjes në Sistem të ZK 2932 Qytet Peshkopi, zonë me peshë kryesore, me synim rritjen e ritmeve të regjistrimit fillestar të pasurive pasqyruar në tabelën emërtuar “Shtrirja e Zonave Kadastrale, Gjendja ne Sistem, Volumet, numri i KPP-ve dhe AMTP-ve, Pasuritë Bujqësore, Trojet dhe numri progresiv i Referencave të regjistrimeve në ZVRPP Dibër”.

Brenda Vitit 2016

Rekomandim 2: ZVRPP Dibër të marrë masa të ndjekë në rrugë ligjore procedurat për vënien nën administrim në arkiv dhe të kërkojë nga Bashkia Peshkopi dhe nga NJQV-të përkatëse dorëzimin e AMTP-ve dhe tërë dokumentacionin e titujve të pronësisë të lëshuara nga Komisionet e Ndarjes së Tokës dhe Strukturat e Tjera që i përkasin **3 fshatrave të futura në sistem përkatësisht: Begjunec zk.1134; Pilafe zk.2928, Rrashnapoje zk. 3135,** dokumentacion i munguar dhe që nuk administrohet fizikisht në arkiven e ZVRPP Dibër. pasqyruar në tabelën emërtuar “Shtrirja e Zonave Kadastrale, Gjendja ne Sistem, Volumet, numri i KPP-ve dhe AMTP-ve, Pasuritë Bujqësore, Trojet dhe numri progresiv i Referencave të regjistrimeve në ZVRPP Dibër ”.

Menjëherë

Gjetje 2: Në ZVRPP Dibër nga 140 fshatra, në arkiv administrohen 104 lista 001 trojesh, **ku mungojnë për 40 fshatra-zk** përkatësisht (Bardhaj Rec zk.1111, Ceren zk.1371, Cetushe zk.1398, Dovolani zk.1521, Fushë-Vogël zk.1662, Hurdhë Rec zk.1973, Kander zk.2072, Kërcisht Epërm zk.2138, Kërcisht Poshtëm zk.2139, Kishavec zk.2153, Kllobcishrt zk.2157, Kodër Leshje zk.2178, Kovashicë zk.2253, Kraj Reç zk.2261, Kullas zk.2319, Majtare zk.2549, Maqellarë zk.2592, Ndershene zk. 2774, Palamani zk.2861, Pesjak zk.2940, Pilafe zk.2958, Ploshtan zk.2997, Pocest zk.3004, Podgoricë zk.3009, Qafë Murrë zk.3080, Rrashnapojë zk.3155, Rreth Kalë zk.3226, Selishtë e Epërme zk.3291, Shumbatë zk.3442, Sinë e Poshtme zk. 3454, Sohodoll zk.3482, Sohod i Vogël zk.3483, Sumaj zk.3548, Trojak zk.3646, Ujemirë zk.3670, Ushtelenca zk.3648, Vasije zk.3717, Venisht zk.3742, Vojnik

zk.3811); që i përkasin **4936 K/Familjarë për 1 480 800 m² truall** (llogaritur sipas normës) prej të cilave; **për 26 fshatra zk në sistem me mbi 3 131 K/familjare me sipërfaqe normë trualli 939 300 m²** (referuar nr të AMTP-ve dhe **për 2 fshatra** përkatësisht:ZK.2958 fshati Pilafe dhe zk. 3155 fshati Rrashnapojë mungojnë edhe AMTP) mungesa është e pajustificuar sa kohë që këto zona kanë hyrë në sistem (me të cilat duhet të kenë punuar NJMP), dhe gjithashtu mungojnë edhe **për 14 zk të pa përfshira në sistem me 1805 K/Familjarë me 541 500 m²** paraqitur në tabelën “Fshatra dhe zona kadastrale pa lista trojesh 001 të dorëzuara dhe të munguara në ZVRPP Dibër”; gjendje kjo në kundërshtim me VKM nr. 556, datë 23.10.2000 “Për dorëzimin e dokumentacionit të pronave në ZVRPP”, pasqyruar në tabelat emërtuar “Gjendja e listave 001 të Trojeve e Zonave Kadastrale” dhe tabelën “Gjendja dhe administrimi i AMTP-ve dhe Listave 001 te Trojeve në Arkivin e ZVRPP Dibër“(Trajtuar në faqet 5-10 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 3: ZVRPP Dibër të marrë masa të ndjekë në rrugë ligjore procedurat për vënien nën administrim në arkiv dhe të kërkojë nga Bashkia Peshkopi dhe nga NJQV-të përkatëse dorëzimin e Listave të trojeve 001 që u përkasin **40 fshatrave-zk me 4936 K/Familjarë për 1 480 800 m² truall** (llogaritur sipas normës) prej të cilave; **për 26 fshatra-zk në sistem me mbi 3 131 K/familjare me sipërfaqe normë trualli 939 300 m² dhe për 14 fshatra-zk të pa përfshira në sistem me 1805 K/Familjarë me 541 500 m²** paraqitur në tabelën “Fshatra dhe zona kadastrale pa lista trojesh 001 të dorëzuara dhe të munguara në ZVRPP Dibër”; dhe në tabelat emërtuar “Gjendja e listave 001 të Trojeve e Zonave Kadastrale” dhe “Gjendja dhe administrimi i AMTP-ve dhe Listave 001 te Trojeve në Arkivin e ZVRPP Dibër“.

Menjëherë

Gjetje 3: Në ZVRPP Dibër ka mungesa e mangësi në lidhur me dorëzimin dhe administrimin e dokumentacionit, me përfshirjen në sistem të regjistrimit fillestar të disa zonave kadastrave, përfshirë Qytetin që kanë sjellë si pasoje pamjaftueshmëri në Menaxhimin e kësaj Zyre vendore Regjistrimi dhe ndër vite nivele kanë pasuar nivele të ultë regjistrimi pasurish, rritje të praktikave në proces, shërbim te paplotësuar të qytetarëve si në periudhat e mëparshme me ndikim edhe në periudhën pasuese vitet 2013-2015 pasqyruar në tabelën “**Regjistrimi i Pasurive dhe transaksionet e tjera për Periudhën 2013, 2014 dhe 2015 ZVRPP Dibër Tabela nr.4**“.

Pra performanca e punës së ZVRPP Dibër prej vitesh vlerësohet nga nivele të ulta të regjistrimeve fillestare të pasurive (megjithë rritjen e konstatuar në periudhën 2013-2015, por përsëri regjistrimet fillestare janë ende të ultë), ku predominojnë transaksionet mbi regjistrimet fillestare shprehur nga treguesi “*struktura në % e regjistrimeve fillestare ndaj transaksioneve dhe ndikimi në rritjen e të ardhurave*”, tregues i cili shpreh se me totalin prej 8,3% e veprimeve në regjistrimin fillestar është prodhuar 33,6% të ardhurave ndarë sipas viteve: ne vitin 2013 me 13,3% regjistrime fillestare kundrejt totalit të regjistrimeve kanë siguruar 47% të ardhurave; ne vitin 2014 me 7,3% regjistrime fillestare kundrejt totalit kanë siguruar 31,3% të ardhurave dhe për vitin 2015 me 6,7% regjistrime fillestare kundrejt totalit kanë siguruar 27,1% të ardhurave; tregues këta që na çojnë në konkluzionin se: puna e ZVRPP Dibër duhet të përqendrohet në regjistrimet fillestare pra predominancën dhe rritjen e peshës në strukture të regjistrimeve fillestare kundrejt veprimeve të transaksioneve me synim përmirësimin e menaxhimit në **përmbushjen e objektivit kryesor strategjik** “Regjistrimi fillestar i pasurive”, Qëllimit, Misionit dhe Vizionit të ZVRPP Dibër në përputhje me kërkesat dhe hapat që duhen ndjekur për instalimin e kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, dhe në zbatim neneve 19,21,22 e vijim të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, paraqitur në tabelën emërtuar “**Regjistrimet Fillestare dhe Transaksionet e Kryera në Periudhën**

2013,2014 dhe 2015, sipas Formularit të ardhurave ZVRPP Dibër Tabela nr. 5” (Trajtuar në faqet 5-10 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 4: ZVRPP Dibër marrë masa në drejtim të rritjes së numrit të regjistrimeve fillestare me predominancë rritjen e peshës në strukture të regjistrimeve fillestare kundrejt veprimeve dhe transaksioneve të tjera mbi pasuritë, me synim përmirësimin e menaxhimit në **përmbushjen e objektivit kryesor strategjik** “Regjistrimi fillestar i pasurive”, të Qëllimit, Misionit dhe Vizionit të ZVRPP Dibër në përputhje me kërkesat dhe hapat që duhen ndjekur për instalimin e kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe në zbatim neneve 19,21,22 e vijim të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, paraqitur në tabelat emërtuar **“Regjistrimi i Pasurive dhe transaksionet e tjera për Periudhën 2013, 2014 dhe 2015 ZVRPP Dibër Tabela nr.4”** dhe **“Regjistrimet Fillestare dhe Transaksionet e Kryera në Periudhën 2013,2014 dhe 2015, sipas Formularit të ardhurave ZVRPP Dibër Tabela nr. 5”**.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

Gjetje : 4 (I.a). ZVRPP Dibër në **zk 1850** fshati **Grazhdan** sipas listave te trojeve 001,dhe PIII ka çelur KPP për 133 K/familjarë të pajisur me AMTP për sipërfaqe të shpërndarë prej 1 122744 m² tokë bujqësore dhe truall ku brenda AMTP-ve janë trajtuar 109 Kf me truall në sipërfaqen 29 449 m² (mbi normë 7649 m²(29449-109x200) dhe nga ana tjetër **ndërsa sipas listës 001 të trojeve miratuar nga K/Plaku dhe Kryetari i Komunës jepen 138 K/Familjarë me 28890 m² truall (nga të cilët 11 K/F kanë sipërfaqe tepër +1420 m² mbi normë dhe trajtuar me nga 2 troje; gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, me ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, me nenin 25 të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 dhe nenin 10 të Dekretit nr. 5747, datë 29.6.1978 ”Për Hartimin, Miratimin dhe Zbatimin e Planeve Rregulluese të Qyteteve dhe të Fshatrave”ku shprehet: “...Për ndërtimin e banesave vetjake në fshatrat fushore e në përdorim një ngastër deri në 200 m² në fshatrat kodrinore e malore deri në 300 m² dhe në qytete, sipas rastiit, 140 deri 170 m²...”** pasqyruar në tabelën emërtuar **“Tabela e kryefamiljareve dhe AMTP e fshatit Grazhdan ZK 1850 dhe evidentimi i trojeve Kol 6, Hyrë në sistem datë 20.4.2014”**;

ZVRPP Dibër për disa vite, në bashkëpunim me NJQV-të dhe Bashkinë Dibër nuk ka identifikuar rregulluar gjendjen në KPP, nuk rakorduar dhe saktësuar listën e trojeve 001 **jepen 138 K/Familjarë me 28890 m² truall (nga të cilët 11K/F kanë sipërfaqe tepër +1420 m² mbi normë dhe trajtuar me nga 2 troje),me gjendjen PIII dhe KPP-ve ka çelura për 133 K/familjarë pajisur me AMTP shpërndarë 1 122 744 m² tokë bujqësore dhe truall ku brenda AMTP-ve janë trajtuar 109 Kf me truall në sipërfaqen 29449 m² (mbi normë 7649 m² (29449-109x200), mosveprim në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, me ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, me nenin 25 të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012, dhe me nenin 10 të Dekretit nr. 5747, datë 29.6.1978 , datë 29.6.1978” Për Hartimin, Miratimin dhe Zbatimin e Planeve Rregulluese të Qyteteve dhe të Fshatrave” ku shprehet “...Për ndërtimin e banesave vetjake në fshatrat fushore e në përdorim një ngastër deri në 200 m² në fshatrat kodrinore e malore deri në 300 m² dhe në qytete, sipas rastiit, 140 deri 170 m²...”** pasqyruar në tabelën emërtuar **“Tabela e kryefamiljareve dhe AMTP fshatit Grazhdan ZK 1850 dhe evidentimi i trojeve Kol 6, Hyrë në sistem datë 20.4.2014”** (Trajtuar në faqet 21-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 5: ZVRPP Dibër Regjistruesi të marrë masa, në bashkëpunim me Bashkinë Dibër dhe me NJA-të të identifikojë pasuritë e rregullojë gjendjen në KPP, të rakordojë dhe saktësojë listën e trojeve 001 me **138 K/Familjarë me 28890 m² truall (nga të cilët 11K/F kanë sipërfaqe tepër +1420 m² mbi normë dhe trajtuar me nga 2 troje), me gjendjen**

PIII dhe KPP-ve të çelura për 133 K/familjarë të pajisur me AMTP për sipërfaqen prej **1 122 744 m²** tokë bujqësore dhe truall përfshirë në AMTP për 109 Kf me truall në sipërfaqen 29449 m² (mbi normë 7649 m² (29449-109x200), duke veçuar ndarë e regjistruar "shtet" sipërfaqen tepër norme, pasqyruar në tabelën emërtuar "**Tabela e kryefamiljareve dhe AMTP fshati Grazhdan ZK 1850 dhe evidentimi i trojeve Kol 6, Hyrë në sistem datë 20.4.2014**".

Menjëherë

Gjetje 5: Gjithashtu ZVRPP Dibër në zk 1850 fshati Grazhdan nuk ka vepruar në rrugë ligjore për të Kërkuar në KVVTP Prefekti Qarku Dibër për verifikimin e vlefshmërisë ligjore të pasurive bujqësore që i përkasin 60 AMTP-ve të parregullta në formë e përmbajtje pa vula ,firma, me korrigjime, pa kufitar të pasurive si dhe AMTP nr.3852 në emër të G. H. me sipërfaqe 54,809 m² dhe AMTP nr.3872/17 me sipërfaqe 15 731 m², lëshuar në emër "Vakëf", pra jo me emër përcaktues të Subjektit apo Administratorit të njohur nga ligji; mosveprime të cilat kanë sjellë **pa mundësinë e regjistrimit të titujve të pronësisë, në kundërshtim me ligjin** nr. 9948, datë 7.7.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore", i ndryshuar, dhe me VKM nr. 994 si dhe me UKM nr. 2, datë 13.6.2013 "Për Mënyrën e Procedimit të Organeve të Administratës Publike për Pasuritë, të Paluajtshme, të Fituara me Atin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)", UKM nr. 2, datë 13.01.2010 "Për mënyrën e Verifikimit apo Shqyrtimit të Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore" pasqyruar në "**Tabela e kryefamiljareve dhe AMTP fshati Grazhdan ZK 1850 dhe evidentimi i trojeve Kol 6, Hyrë në sistem datë 20.4.2014**"(Trajtuar në faqet 21-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 6: ZVRPP Dibër, Regjistruesi të marrë masa për të vepruar në rrugë ligjore dhe të Kërkojë në KVVTP Prefekti Qarku Dibër dhe në Bashkinë Dibër verifikimin e vlefshmërisë ligjore të pasurive bujqësore që i përkasin 60 AMTP-ve të parregullta në formë e përmbajtje pa vula ,firma, me korrigjime, pa kufitar të pasurive si dhe AMTP nr.3852 në emër të G.H. me sipërfaqe 54,809 m² dhe AMTP nr. 3872/17 me sipërfaqe 15 731 m², lëshuar në emër "Vakëf", pa përcaktuar emrin e Subjektit apo Administratorit të njohur nga ligji; mosveprime të cilat kanë sjellë **pa mundësinë e regjistrimit të titujve të pronësisë.**" pasqyruar në "**Tabela e kryefamiljareve dhe AMTP e fshatit Grazhdan ZK 1850 dhe evidentimi i trojeve Kol 6, Hyrë në sistem datë 20.4.2014**"

Menjëherë

Gjetje 6: ZVRPP Dibër në **zk 1850 fshati Grazhdan për 44 K/f me 244 pasuri tokë bujqësore me sipërfaqe 362420 m² AMTP dhe 368409 m² LN-PIII**, pra të rezultuara me sipërfaqe + **5989 m²** tepër për të cilat nuk është bërë bilanci AMTP-LN PIII, duke mos veçuar e regjistruar "Shtet" sipërfaqen tepër

a. ka lëshuar certifikata për 4 K/F me 18 pasuri me sipërfaqe 19000 m² AMTP dhe 19298 m² LN, pra me sipërfaqe + 298 m² tepër,

b Gjithashtu nuk janë kryer veprime në KPP pra nuk është veçuar e regjistruar "shtet" sipërfaqet tepër për 244 pasuri me sipërfaqe 362420 m² AMTP dhe 368409 m² LN, pra me sipërfaqe 5989 m², në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 "Për tokën", me ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme" dhe me nenin 25 të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012, pasqyruar në tabelën emërtuar "K/F Tokë bujqësore me sipërfaqe mbi AMTP, lëshuar certifikata, kryer transaksione pa veçuar "Shtet" sipërfaqen tepër ZK.1850 Grazhdan**" (Trajtuar në faqet 21-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).**

Rekomandim 7: ZVRPP Dibër, Regjistruesi të marrë masa për **zk 1850 fshati Grazhdan për 44 K/f me 244 pasuri tokë bujqësore me sipërfaqe 362420 m² sipas AMTP –ve dhe**

368409 m² sipas LN-PIII, pra me sipërfaqe tepër + **5989** m², të bëjë bilancet AMTP-LN PIII, dhe të veçojë e regjistrojë “Shtet” sipërfaqen tepër përkatësisht:

a. Për **4** K/F me **18** pasuri me sipërfaqe **19000** m² sipas AMTP dhe **19 298** m² sipas LN, me sipërfaqe tepër, + **298** m² duke shfuqizuar *certifikatat e lëshuara*,

b Për **244** pasuri me sipërfaqe **362420** m² sipas AMTP dhe **368 409** m² sipas LN, me sipërfaqe tepër +**5989** m² **pa veprime në KPP**, pasqyruar në tabelën emërtuar “**K/F Tokë bujqësore me sipërfaqe mbi AMTP, lëshuar certifikata, kryer transaksione pa veçar “Shtet” sipërfaqen tepër ZK.1850 Grazhdan**”.

Menjëherë

Gjetje 7: ZVRPP Dibër në Volumet e KPP-ve të çelura në 141 Zona Kadastrale, mbi të cilat kryhen veprime mbi PPL, 121 Zona Kadastrale ndodhen pa vulë e firmë të Regjistruesit dhe në 3 Zona Kadastrale KPP-të janë vetëm me vulë dhe pa firmë, ndërsa vetëm në 4 ZK janë KPP-të janë me vulë e firmë të regjistruesit; megjithëse mbi to prej disa vitesh punohet nga personeli për regjistrimet dhe transaksionet e pasurive, pasqyruar në tabelën emërtuar “Gjendja Rregullative e KPP-ve sipas Zonave Kadastrale në ZVRPP Dibër”; gjendje kjo në kundërshtim me nenet 7, 19, 23 27 të ligjit nr.33, datë 21.3.2012”Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” me Rregulloren nr. 184, datë 18.4.1999 “Për Punën në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, të ndryshuar (Trajtuar në faqet 21-26 të Projektraportit të Auditimit).

Rekomandim 8: ZVRPP Dibër, Regjistruesi të marrë masa dhe plotësoje me vulë e firmë Volumet e KPP-ve të çelura në 141 Zona Kadastrale, mbi të cilat kryhen veprime mbi PPL, për 121 Zona Kadastrale me KPP të ndodhura pa vulë e firmë të Regjistruesit, dhe për 3 Zona Kadastrale me KPP me vulë dhe pa firmë, mbi të cilat prej disa vitesh punohet nga personeli për regjistrimet dhe transaksionet e pasurive, pasqyruar në tabelën emërtuar “Gjendja Rregullative e KPP-ve sipas Zonave Kadastrale në ZVRPP Dibër”.

Gjetje 8: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP), pranë Prefektit të Qarkut *Dibër* për periudhën 2013-2015, nuk ka dërguar pranë ZVRPP Dibër asnjë projektvendim, Vendim, vendim gjykate dhe nuk ka përfshirë si palë në proceset gjyqësore si dhe ka drejtuar ZVRPP Dibër gjithsejtë 7 shkresa (nga të cilat 3 shkresa “vënie dijani”, në vitin 2014 dhe 4 shkresa “kërkesë dokumentacioni ose kërkesa për konfirmim”, për informacion, verifikim, konfirmim gjendjes juridike të Titujve të pronësisë së tokës bujqësore për të cilat nga ZVRPP Dibër për 2 vënie dijani nuk ka pas nevojë për përgjigje ndërsa për 4 kërkesa është dhënë përgjigje; gjithashtu vetë ZVRPP Dibër po për të njëjtën periudhë për vitin 2015 i ka drejtuar KVVTP vetëm 7 Kërkesa për verifikim e vlerësim të titujve të pronësisë, prej të cilave 3 janë me përgjigje të vonuar nga 1,4,7 muaj dhe 4 kërkesave nuk ju është përgjigjur KVVTP); gjendje kjo që tregon pamjaftueshmëri e mungesë bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve që ka sjellë si pasojë nivele të ulta të regjistrimit të pasurive bujqësore, të cilat kanë dokumentacion me problematika të mëdha të titujve të pronësisë; gjendje kjo në kundërshtim dhe në mos përmbushje të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008 ”Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, i ndryshuar, dhe me UKM nr. 2, datë 13.6.2013 “Për Mënyrën e Procedimit të Organeve të Administratës Publike për Pasuritë, të Paluajtshme, të Fituara me Atin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP).

I. Lidhur me marrëdhëniet ndërmjet KVVTP dhe ZVRPP Dibër për vitin 2013-2015 nuk është kërkuar informacion nga ZVRPP në KVVTP për ecurinë e procesit të verifikimit dhe nuk janë marrë masat kufizuese për pasuritë:

A. Për pasuritë që i përkasin 8 AMTP-ve lëshuar për 4 K/F në ZK2932 Peshkopi përkatësisht:

a.AMTP nr.2 datë 26.12.2013 në emër të M.I.S Bashkia Peshkopi zk.2932

b. AMTP nr. 3 datë 26.12.2013 në emër të V.V.Sh Bashkia Peshkopi zk.2932

c. Për 5 AMTP me AMTP nr.4, nr.5 nr.6, nr. 7 dhe nr. 8, datë 26.12.2013 në emër të N. M.M. Bashkia Peshkopi zk.2932

d. AMTP nr.9, datë 26.12.2013 në emër të M. A.T.Bashkia Peshkopi zk. 2932,

e. AMTP nr. 1 datë 26.12.2013 në emër të **B.F.Sh.** Bashkia Peshkopi zk. 2932

B. Për pasuritë që i përkasin AMTP-ve të **9 fshatrave (Kalle, ZallKalis, Venisht, Vçeshte, Shumbat, Trojak, Sllatinë, Dipjake, Sillovë dhe Palaman) Komuna Sillovë,**

C.Mos kërkim informacioni në KVVTP për ecurinë e procesit të verifikimit të pasurive të **Fshatin Vakuf zk.2300, Komuna Kastriot,**

D. Për AMTP nr. 5865, datë 28.7.1995 në emër të G (B) V. I. të 3 pasurive me sipërfaqen 34 375 m² tokë bujqësore për të cilat janë lëshuar certifikata datë 30.5.2015 përkatësisht: pasuria nr. 119/78, v.2, f. 247, zk. 2157 Kllopcisht‘Arë”, me sipërfaqe 19 375 m², pasuria nr. 119/158, v. 2, f. 248, zk. 2157 Kllopcisht‘Arë”, me sipërfaqe 12 300 m², dhe pasuria nr. 120/4, v. 2, f. 249, zk. 2157 Kllopcisht‘Arë”, me sipërfaqe 2 750 m²;

E. lidhur me pasuritë me pavlefshmëri ligjore të listës prej **39 AMTP-ve me sipërfaqe 381 240 m²**, përkatësisht: shfuqizim të plotë të listës me **27 AMTP –ve lëshuar v. 2000, me sipërfaqe 332 820 m²** dhe shfuqizim të pjesshëm të listës me **12 AMTP–ve lëshuar v. 2000, me sipërfaqe 48 420 m²** për të cilat ZVRPP Dibër dhe 8 AMTP-ve Fshatit Maqellarë ZK. 2592, Komuna Maqellarë,

F. Për AMTP nr. 26877 datë 20.4.2004 në emër familjes bujqësore **O.A.S.** të 2 pasurive me sipërfaqen 9487 m² tokë bujqësore ZK. 2932 përkatësisht: pasurinë nr. 121 e llojit pemëtores me sipërfaqe 5312 m², zk. 2932 pronë “shtet” poseduar nga **V.V.**, dhe pasuria nr. 128/2 e llojit arë me sipërfaqe 4375 m², zk. 2932 pronë “shtet”, poseduar nga **Osman A. S.**; fakte këto që kanë sjellë si pasoje pamjaftueshmëri, mungesë bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve mungesë të ecurisë së procesit të verifikimit të titujve të pronësisë, nivele të ultë të regjistrimit të pasurive bujqësore, të cilat kanë dokumentacion me problematika të mëdha të titujve të pronësisë mosveprime në kundërshtim me ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore” dhe me nenet 59,60,74 të ligjit nr. 33/2012 datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, krahas KVVTP Prefekti Qarkut Dibër, i cili ka detyrë ligjore funksionale ushtrimin e procesit,

II. Lidhur me marrëdhëniet ndërmjet ZVRPP dhe KVVTP Dibër për vitin 2013-2015 nuk është konfirmuar dhe kërkuar informacion nga ZVRPP në KVVTP për ecurinë e procesit të verifikimit dhe nuk janë marrë masat kufizuese për pasuritë:

A. Për 3 AMTP-të lëshuar për 3 K/F në ZK2469 Peshkopi përkatësisht:

- AMTP nr. 5 datë 20.6.2015 (AMTP jeshile) në emër të **S.T.K.** “arë”, me sipërfaqe 5200 m² e cila një pjesë prej 4052 m² ndodhet në pasurinë nr. 1711, v.3, f. 37, lloji “arë” zk.2469 Luzni “shtet”; ndërsa pjesa tjetër prej 1148 m² (5200-4052 m²), shtrihet në pasurinë nr. 1586/10, v.3, f.131, zk.2489 e llojit “kullotë” me sipërfaqe 720387 m² “kullotë” pra sipërfaqja pjesë 1148 m² mbivendoset me ndryshim zëri kadastral nga “kullotë” në “arë”
- AMTP nr. 1, datë 20.06.2015, zk,2469, në emër të S. Q.M., fshati Lishan i Epër, Njësia Administrative Luzni, Bashkia Peshkopi,
- AMTP nr.8, datë 08.10.2015, zk,2469, në emër të Sh. S., fshati Pjeçe Njësia Administrative Melan, Bashkia Peshkopi;

B. AMTP nr. **8, datë 09.06.2015,** (AMTP jeshile pasuria nr nr.201/1, me sipërfaqe 270 m² zk. 2649 Melan Komuna Melan, e dhëne për “arë” është e llojit “truall” pasi është pjesë e pasurisë 201/4, v.4, .32 zk. 2649 me sipërfaqe 7142 m² “truall”, **pra ka ndryshim të zërit kadastral nga “truall” në “arë”,**

C. AMTP nr. 19319, pa datë **S. R,pasuritë me bilancin si më poshtë: norma 6750, fakt 9280 tepër +2530 m² konkretisht:** pas. nr.747, v. 1, fq.24 , pas. nr.77,4/6 v. 1, fq.25, pas.

nr.746/4, v. 1, fq.26, pas. nr.776/4, v. 1, fq.27, pas. nr.775/1, v. 1, fq.28, pas. nr.701/1, v. 1, fq.29 ZK2469;

AMTP nr. 19247, pa datë në emër të **H.R. me bilancin si më poshtë: për të cilën kërkuar shfuqizimi plotë sipërfaqe tepër +2631m² konkretisht:** pas. nr. 790/4, v. 1, fq. 14, pas. nr. 777/2, v. 1, fq. 15 ZK2469, pasi pasuritë janë pa titull pronësie të mbivendosura, dhe në proces gjyqësor.

Rekomandim 9: ZVRPP Dibër, Regjistruesi të marrë masa të vendosë masa kufizuese në baze të neneve 59,60 dhe 74 të ligjit (deri në përfundimin e procedurave ligjore të verifikimit) si dhe të kërkojë japë informacionin e munguar tek KVVTP për ndjekjen e procedurave të verifikimit, mbi pasuritë objekt të kërkesave të KVVTP në proces verifikimi viti 2013-2015 përkatësisht për AMTP-të dhe pasuritë:

A. Për pasuritë që i përkasin 8 AMTP-ve lëshuar për 4 K/F në ZK2932 Peshkopi përkatësisht:

a. AMTP nr.2 datë 26.12.2013 në emër të M.I. S. Bashkia Peshkopi zk.2932

b. AMTP nr.3 datë 26.12.2013 në emër të V.V.Sh. Bashkia Peshkopi zk.2932

c. Për 5 AMTP me AMTP nr. 4, nr. 5 nr. 6, nr. 7 dhe nr. 8, datë 26.12.2013 në emër të N.M.M. Bashkia Peshkopi zk.2932.

d. AMTP nr.9, datë 26.12.2013 në emër të M. A. T. Bashkia Peshkopi zk. 2932,

e. AMTP nr. 1 datë 26.12.2013 në emër të **B.F.Sh.** Bashkia Peshkopi zk. 2932

B. Për pasuritë që i përkasin AMTP-ve të **9 fshatrave (Kalle, ZallKalis, Venisht, Vceshte, Shumbat, Trojak, Sllatinë, Dipjake, Sillovë dhe Palaman) Komuna Sillovë,**

C. Për pasuritë që i përkasin AMTP-ve lëshuar nga Komisioni Ndarjes Tokës në Fshatin Vakuf zk.2300, Komuna Kastriot.

D. Për AMTP nr. 5865, datë 28.7.1995 në emër të G. (B.) V. I. të 3 pasurive me sipërfaqen 34 375 m² tokë bujqësore për të cilat janë lëshuar certifikata datë 30.5.2015 përkatësisht: pasuria nr. 119/78, v.2, f. 247, zk. 2157 Kllopcisht‘Arë”, me sipërfaqe 19 375 m², pasuria nr. 119/158, v. 2, f. 248, zk. 2157 Kllopcisht‘Arë”, me sipërfaqe 12 300 m², dhe pasuria nr. 120/4, v. 2, f. 249, zk. 2157 Kllopcisht‘Arë”, me sipërfaqe 2 750 m²;

E. lidhur me pasuritë shpallur me pavlefshmëri ligjore në listën prej **39 AMTP-ve me sipërfaqe 381 240 m²**, përkatësisht: shfuqizim të plotë të listës me **27 AMTP –ve lëshuar v. 2000, me sipërfaqe 332 820 m²** dhe shfuqizim të pjesshëm të listës me **12 AMTP–ve lëshuar v. 2000, me sipërfaqe 48 420 m²** për të cilat ZVRPP Dibër dhe 8 AMTP-ve Fshatit Maqellarë ZK. 2592, Komuna Maqellarë,

F. Për AMTP nr. 26877, datë 20.4.2004 në emër familjes bujqësore **O. A.S.** të 2 pasurive me sipërfaqen 9487 m² tokë bujqësore ZK. 2932 përkatësisht: pasurinë nr. 121 e llojit pemëtore me sipërfaqe 5312 m², zk. 2932 pronë “shtet” poseduar nga **V.V.**, dhe pasuria nr. 128/2 e llojit arë me sipërfaqe 4375 m², zk. 2932 pronë “shtet”, poseduar nga **O.A.S.** (*Trajtuar në faqet 44-59 të Projektraportit të Auditimit*).

Menjëherë

Rekomandim 10: ZVRPP Dibër, Regjistruesi të marrë masa të vendosë masa kufizuese në baze të neneve 59,60 dhe 74 të ligjit (deri në përfundimin e procedurave ligjore të verifikimit) si dhe të kërkojë japë informacionin e munguar tek KVVTP për ndjekjen e procedurave të verifikimit, mbi pasuritë objekt të kërkesave të ZVVRPP në proces verifikimi viti 2013-2015 përkatësisht për AMTP-të dhe pasuritë:

A. Për 3 AMTP-të lëshuar për 3 K/F në ZK2469 Peshkopi përkatësisht:

- AMTP nr. 5 datë 20.6.2015 (AMTP jeshile) në emër të **S.T.K.** “arë”, me sipërfaqe 5200 m² e cila një pjesë prej 4052 m² ndodhet në pasurinë nr. 1711, v.3, f. 37, lloji “arë” zk.2469 Luzni “shtet”; ndërsa pjesa tjetër prej 1148 m² (5200-4052 m²), shtrihet në pasurinë nr. 1586/10,

v.3, f.131, zk.2489 e llojit “kullotë” me sipërfaqe 720387 m² “kullotë” pra sipërfaqja pjesë 1148 m² mbivendoset me ndryshim zëri kadastral nga “kullotë” në “arë”

-AMTP nr. 1, datë 20.06.2015, zk,2469, në emër të S.Q.M.fshati Lishan i Epër, Njësia Administrative Luzni, Bashkia Peshkopi,

-AMTP nr.8, datë 08.10.2015, zk,2469, në emër të Sh.S., fshati Pjeçe Njësia Administrative Melan, Bashkia Peshkopi;

B. AMTP nr. 8, datë 09.06.2015, (AMTP jeshile pasuria nr nr.201/1, me sipërfaqe 270 m² zk. 2649 Melan Komuna Melan, e dhëne për “arë” është e llojit “truall” pasi është pjesë e pasurisë 201/4, v.4, .32 zk. 2649 me sipërfaqe 7142 m² “truall”, **pra ka ndryshim të zërit kadastral nga “truall” në “arë”,**

C. AMTP nr. 19319, pa datë **S. Re., pasuritë me bilancin si më poshtë: norma 6750, fakt 9280 tepër +2530 m² konkretisht:** pas. nr.747, v. 1, fq.24 , pas. nr.77,4/6 v. 1, fq.25, pas. nr.746/4, v. 1, fq.26, pas. nr.776/4, v. 1, fq.27, pas. nr.775/1, v. 1, fq.28, pas. nr.701/1, v. 1, fq.29 ZK2469;

AMTP nr. 19247, pa datë në emër të **H. R. me bilancin si më poshtë: për të cilën kërkuar shfuqizimi plotë sipërfaqe tepër +2631m² konkretisht:** pas. nr. 790/4, v. 1, fq. 14, pas. nr. 777/2, v. 1, fq. 15 ZK2469, pasi pasuritë janë pa titull pronësie të mbivendosura, dhe në proces gjyqësor.

Menjëherë

Gjetje 9: ZVRPP Dibër për vitin 2014 ka pranuar e regjistruar **34 leje ndërtimi objektivsh** mbi truall shtetëror e privat, me mangësi në formë e përmbajtje të dokumentacionin përbërës, prej të cilave në **26 leje** sheshi ndërtimi të lëshuara nga Bashkia në vitet 1997-2011 mbi truall publik në sipërfaqen **1945 m²**, dërguar për regjistrim te objekteve në periudhën tetor 2013-nëntor 2014 paraqitur në tabelën emërtuar “Regjistrimi i Lejeve të Ndërtimit lëshuar në troje publike nga Bashkia pa Marrëdhënien e Truallit dhe Efekti i vlerës së Truallit dhe Vlera e Qirasë së Akumuluar Viti 2014”, duke mos refuzuar e kthyer dokumentacionin e mangët, mos kërkuar ndaj Bashkisë Dibër zgjidhjen e marrëdhënies së truallit me pasojë detyrimet e rrjedhura në vlerën **26,189,338 lekë** ndarë: **6 636 538 lekë vlerë trualli** (llogaritur sipas VKM) dhe vlera prej **19 552 800 lekë nivel qiraje** nga përdorimi dhe zënia me ndërtim pa titull pronësie, për të cilat ZVRPP Dibër nuk ka vendosur as barrë mbi pronë mbi pasuritë ndërtimore të paktën në vlerën përkatëse të qirasë së përdorimit, dukë shkaktuar demin ekonomik të mësipërm për buxhetin e Bashkisë; *në kundërshtim me nenin 30, 32 të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për Urbanistikën”, i ndryshuar, me nenin 13 të ligjit nr 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, në kundërshtim me UKM nr. 3, datë 15.,2.2001 i ndryshuar “Për Kontrollin dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”, me ndryshime, në kundërshtim me kreun IV pikat 12.1-7 të Rregullores nr. 184, datë 18.4.1999 “Për Punën në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, në kundërshtim me nenin 46, pikat 1-5 të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, dhe në pikën 4 ku shprehet: “...Regjistruesi informon brenda 10 ditëve organet e administratës tatimore për regjistrimin e lejes së ndërtimit...” dhe në bazë të ligjit 33/2012 nenit 23 ku shprehet:”...Regjistruesi dhe çdo punonjës tjetër i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme mbajnë përgjegjësi ligjore për veprimet dhe aktet e lëshuara prej tyre (Trajtuar në faqet 90-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

Rekomandim 11: ZVRPP Dibër, Regjistruesi të nxjerrë urdhër të veçantë të vendosë barrë mbi pronën në seksionin “D” të KPP-ve ZK.2932 Qytet dhe në Regjistrat Hipotekore në vlerën **6 636 538 lekë** vlerë trualli (llogaritur sipas VKM) dhe vlera prej **19 552 800 lekë** nivel qiraje nga përdorimi dhe zënia me ndërtim pa titull pronësie, mbi pasuritë e llojit ndërtesa nga **26 leje** sheshi ndërtimi të lëshuara nga Bashkia në vitet 1997-2011 mbi truall publik në sipërfaqen **1945 m²**, dërguar për regjistrim te objekteve në periudhën tetor 2013-

nëntor 2014, të regjistruara pa marrëdhënie trualli dhe me dokumentacion të parregullt deri në likuidimin e detyrimeve ndaj Bashkisë Peshkopi dhe zgjidhjen ligjore të pronësisë mbi truallin ; si dhe të njoftojë e ti kërkoje Bashkisë Peshkopi zbatimin e procedurave ligjore dhe kontratore rrjedhur nga lejet e shesheve, dhënia e lejeve të përdorimit të ndërtesave deri në heqjen e barrëve mbi këto pasuri, paraqitur në tabelën emërtuar “Regjistrimi i Lejeve të Ndërtimit lëshuar në troje publike nga Bashkia pa Marrëdhënien e Truallit dhe Efekti i vlerës së Truallit dhe Vlera e Qirasë së Akumuluar Viti 2014”.

Brenda 15 Dhjetor 2016

Gjetje 10: ZVRPP Dibër për vitin 2015 ka pranuar e regjistruar dokumentacionin me mangësi në formë e përmbajtje të **16 leje legalizimi objektsh** mbi truall shtetëror e privat (nga të cilat 11 në ZK 2592 Maqellarë dhe 5 në disa zk si: zk 2940 Pejsjak, zk 3023 Pollozhan, zk 3509 Staravec, zk3605 Tomin zk 2549 Fshati Mastare), me shkelje të afateve nga 2-7 muaj, në kundërshtim me KPA, me dokumentacion të pa inventarizuar te 11 dosjeve, në zk 2592 Maqellarë ne kundërshtim me rregulloren nr. 2079 “Për arkivimin e Dokumentacionit në ZVRPP”, me mangësi në çeljen e mbajtjen ligjore të veprimeve në KPP në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 13.4.2006 ”Për Legalizimin Urbanizimin dhe Integrimin e Zonave me Ndërtime Informale”, i ndryshuar, me lejen e legalizimit, me ndryshime të zërave kadastral në kundërshtim me ligjin nr. 10 257, datë 25.3.2010 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8752, datë 26.3.2001 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Strukturave të Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës”, pasi në tejkallim të kompetencave la lejuar ndryshimin e kufirit ligjor të zërit kadastral “Pemëtore”, ”arë”, në emërtime zërash kadastral të përzier e të jashtëligjshëm e të pasqyruar në KPP dhe lëshuar në certifikatë me zë kadastral të tej kufirit të lejes legalizimit për 500m² dhe në kundërshtim me ligjin nr. 33, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, me Rregulloren nr. 184, datë 18.4.1999 “Për Punën në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, Kreu II pika 11, Kreu III pika 4, Kreu VI pika 5, 5.1 d (Trajtuar hollësisht në faqet 129-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 12.: ZVRPP Dibër, Regjistruesi me urdhër të veçantë, të kryej veprimet sipas referencës **nr. 0588**, aplikim nr. 2247, datë 17.08.2015 në KPP (manuale) pasuria “mëmë” nr. 219, v. 2, f. 163 zk 2592, ”Arë” me sipërfaqe AMTP 1000 m²- Ln 684 m², duke e mbyllur dhe ndarë atë, në 2 pasuri përkatësisht: a. në pasurisë nr. v, f. zk 2592 i parcelës ndërtimore në sipërfaqen prej 500 m² “truall” mbi të cilën të regjistrohej Banesa 2kt me sn 135,4 m² dhe b. në pasurinë nr. , v., fq, zk 2592 e llojit “arë” në sipërfaqen AMTP 500 m²-LN 184 m².

Menjëherë

Rekomandim 13: ZVRPP Dibër, Regjistruesi me urdhër të veçantë, të kryej veprimet sipas referencës **nr. 0594**, aplikim nr. 2660, datë 28.09.2015 në KPP (manuale) pasuria “mëmë” pasuria nr. 560, v.7, f.14 zk.2592 Maqellarë e llojit “arë” me sipërfaqe 906 m²zk 2592 Maqellarë duke e mbyllur dhe ndarë atë, në 2 pasuri përkatësisht: a. në pasurisë nr. v, f. zk 2592 i parcelës ndërtimore në sipërfaqen prej 500 m² zëri “truall” mbi të cilën të regjistrohej Banesa 2kt me sn 212,5 m² dhe b. në pasurinë nr. , v., fq, zk 2592 e llojit “arë” në sipërfaqen 406 m² (906 m²-500 m²);

Menjëherë

Rekomandim 14: ZVRPP Dibër, Regjistruesi me urdhër të veçantë, të kryej veprimet sipas referencës **nr. 0603**, aplikim nr. 3018, datë 28.10.2015 në KPP (manuale) pasuria “mëmë” nr. 156, v.4, f. 12 zk. 2592 Maqellarë e llojit “arë” me sipërfaqe LN 335 m², me gjendje juridike “shtet”; për parcelën ndërtimore në sipërfaqen zëri “truall” mbi të cilën të regjistrohet Banesa 2kt me sn 122,4 m² .

Menjëherë

Rekomandim 15: ZVRPP Dibër Regjistruesi me urdhër të veçantë të vendosë kufizim mbi pasurinë nr. 154/1, v.7, f.42 zk2592 Maqellarë e llojit “Truall” me sipërfaqe LN 216,9 m², deri në identifikimin dhe ofrimin tek përfituesi i lejes legalizimit nga ALUIZN të pasurisë së veçuar KPP nr. 154/2, v.7, f.43 zk2592Maqellarë e llojit “Truall” me sipërfaqe 11,1 m² “shtet”; të cilën nga veprimet e parregullta të procedurës legalizimit dhe të ndarjes së pasurisë aktualisht ndodhet e nxjerrë jashtë funksioni me veprimet sipas **Referencës nr. 0606, 22.02.16**, aplikim nr. 3072, datë 2.11.2015.

Menjëherë

Rekomandim 16 : ZVRPP Dibër, Regjistruesi me urdhër të veçantë, të kryej veprimet sipas referencës **nr. 0148, 25.215**, aplikim nr. 738, datë 10.2.2015 në KPP (manuale) pasuria “mëmë” nr.24, v.2, f.170 zk.2549 e llojit “arë” me sipërfaqe AMTP 4770 m² LN 4500 m² zk 2549 Mastare, duke e mbyllur dhe ndarë atë, në 2 pasuri përkatësisht: a. në pasurisë nr. 24/1, v.4, f.248 zk 2549 Mastare, “Truall” i kthyer nga zëri “arë” i parcelës ndërtimore në sipërfaqen prej 500 m² “truall” mbi të cilën të regjistrohej Banesa 3kt me sn 141,6 m² dhe b. në pasurinë nr. 24/2 v. f. zk. 2549 “arë “ me sipërfaqe AMTP 4270 m² (4770-500) LN 4000 m² (4500-500), në pronësi të pronarit.

Menjëherë

Rekomandim 17 : ZVRPP Dibër Regjistruesi me urdhër të veçantë të vendosë Kufizim mbi KPP pasurinë nr. 203, v.2, f.232 zk 3605 Tomin parcelës ndërtimore 514 m² Ndërtesë Banimi 2kt me sipërfaqe ndërtimi 429 m², deri në plotësimin e dokumentacionit shkresë përcjellëse, dhe identifikimin e origjinës të KPP –së së çelur sipas **Referencës nr. 0103, 20.5.13**, aplikim nr. 606, datë 15.5.2013.

Menjëherë

Rekomandim 18: ZVRPP Dibër, Regjistruesi me urdhër të veçantë, të kryej veprimet sipas referencës **nr. 0171, 16.2.15**, aplikim nr. 595 datë 30.01.2015 në KPP (manuale) pasuria “mëmë” nr. 814/3, v.4, f.212 zk 3509 Staravec “pemëtore” me sipërfaqe 1500 m², duke e mbyllur dhe ndarë atë, në 2 pasuri përkatësisht:

- a. KPP pasurinë nr. 814/9, v.4, f.231 zk 3509 Staravec me 538,8 m² “Truall–ndërtesë”
- b. KPP pasurinë nr., v., f. zk 3509 Staravec me 961 m² pemëtore (1500-538,8)

Menjëherë

Rekomandim 19: ZVRPP Dibër, Regjistruesi me urdhër të veçantë, të kryej veprimet sipas referencës nr. 099, 12.10.15, aplikim nr.1826 datë 5.06.2015 në KPP (manuale) pasuria “mëmë” nr.98/11, v.3, f.7 zk. 3023 Pollozhan, me sipërfaqe 1200 m “pemëtore” duke e mbyllur dhe ndarë atë, në 2 pasuri përkatësisht :

- a. KPP pasurinë nr.- v.-, f.- zk 3509 Staravec me 500 m² ”truall– ndërtesë”
- b. KPP pasurinë nr., v., f. zk 3509 Staravec me 700 m² pemëtore (1200-500) duke ruajtur kështu zërin kadastral.

Menjëherë

Rekomandim 20: ZVRPP Dibër, Regjistruesi me urdhër të veçantë, të kryej veprimet sipas referencës **nr. 085, 10.12.15**, aplikim nr. 2666 datë 28.9.2015 Q.K.T në KPP (manuale) pasuria “mëmë” nr. 159,v. 1,f. 22 zk.2940 Pejssjak me sipërfaqe arë AMTP 1925 Ln 1750 m²

dhe në KPP nr. 456 v.3,f.41 zk. 2940_Pejsjak duke i mbyllur ato dhe të çelen 3 pasuri përkatësisht:

- a. KPP pasurinë nr.- v.-, f.- zk.2940 Pejsjak me 1311m² “”truall-ndërtesë” në emër të Q.K. T.,
- b. KPP pasurinë nr., v., f zk.2940_Pejsjak me 401,5 m² arë (1750-1311- 37,5) në emër të Q. K. T., duke ruajtur kështu zërin kadastral.
- c. KPP pasurinë nr., v., f. zk.2940 Pejsjak me 37,5 m², në pronësi “shtet”, të zaptuar pa titull pronësie me ndërtesë nga Q. K.T., ose të likuidojë në vlerën e tregut .

Menjëherë

Rekomandim 21: ZVRPP Dibër, Regjistruesi të marrë masa e të kryejë inventarizimin dhe dorëzojë në arkiv të dokumentacionit të pa inventarizuar që i përkasin 11 dosjeve të regjistrimit të pasurive me leje legalizimi v. 2015, në zk 2592 Maqellarë, sipas rregullores nr. 2079 “Për arkivimin e Dokumentacionit në ZVRPP”,

Menjëherë

Gjetje 11: ZVRPP Dibër, për disa vite radhë nuk ka identifikuar, evidentuar, raportuar rehatuar dhe nuk ka zbatuar procedurat për gjendjen dhe regjistrimin e pasurive me mbivendosje.

Gjithashtu ZVRPP Dibër, ka krijuar mbivendosje pasi nuk ka relatuar saktë, në rrugë shkresore zyrtare, në afat dhe nuk ka zbatuar procedurat ligjore për mbivendosjet lidhur me aplikimin datë 05.05.2015 të qytetarit R. (M) I.V., për regjistrim të 4 pasurive bujqësore me sipërfaqe 7930 m² (2300 m² arë +3450 m² Pemëtore + 800 m² arë + 1380 m² Pemëtore) të përfituara me AMTP-të Jeshile nr. 1, 2, 3, 4, datë 10.3.2015, lëshuar nga Komuna Muhurr zk. 1668; aplikuar për regjistrim dhe mbetur në proces prej datës 05.05.2015 pasuri të cilat krijojnë mbivendosje: *a. mbi pasurinë nr. 526/2, v.3, f. 118 zk. 1668, me sipërfaqe 7000 m², pronë e R. B. me origjinë përfituar me AMTP mbivendoset a.1 pasuria nr. 526/7 zk. 1668 me sipërfaqe 800 m² arë me origjinë përfituar me AMTP nr.3, datë 10.3.2015 në emër të R.(M.)I.V. dhe a. 2. mbivendoset dhe pasuria me sipërfaqe 2300 m² arë zk. 1668 me origjinë përfituar me AMTP nr.1, datë 10.3.2015); si dhe b. Mbi pasurinë nr. 511/1, v3, f.29,zk.1668, me sipërfaqe (AMTP 3000 m² - LN 2850 m²) pronë e z. H.Xh. tjetërsuar në emër të N.Xh. me referencën nr. 39, datë 17.01.2008), *mbi të cilën mbivendoset në sipërfaqen* (një pjesë, papërcaktuar) pasuria tjetër me sipërfaqe totale 1380 m² Pemëtore me origjinë përfituar nga AMTP nr. 4, datë 10.3.2015, në emër të R. (M.) I.V., si dhe nuk ka marrë masat e duhura ligjore në kohë duke mos ndjekur procedurat ligjore për zgjidhjen e mbivendosjeve, nuk janë vendosur masat kufizuese mbi KPP në kundërshtim me nenet 59,60 dhe 74 (sa kohë ka lindur ngjarja) moszbatimin e afatit 1 muhor të KPA, mos nxjerrjen e urdhrat administrativ për refuzimin e regjistrimit, të pjesëve të mbivendosura,mos njoftimin dhe mos orientimin e palëve për rrugën gjyqësore; në kundërshtim me Kreun V, nenit 37, paragrafi i 3, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme, me nenin 10 të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe me rregulloren nr. 184, datë 18.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të paluajtshme“, të ndryshuar Kreu i VI, pikat 5 dhe 5.2 (*Trajtuar hollësisht në faqet. 172-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)*

Rekomandim 22: ZVRPP Dibër, Regjistruesi të marrë masa, për evidentuar raportuar relatuar gjendjen dhe regjistrimin e pasurive me mbivendosje, mbetur pa identifikuar evidentuar disa vite radhë, si dhe të zbatojë procedurat e duhura ligjore për trajtimin e pasurive regjistruar me mbivendosje.

Menjëherë dhe vazhdimisht

Rekomandim 23: ZVRPP Dibër, Regjistruesi të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të ligjit nr. 33/2012, datë 29.4.2012”Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 5 pika 1, neni 59, 60, 74 të njoftojë palët dhe orientojë zgjidhjen gjyqësore, përkatësisht :

Mbi AMTP-të Jeshile nr. 1, 2, 3, 4, datë 10.3.2015, lëshuar nga Komuna Muhurr zk. 1668; aplikuar për regjistrim dhe mbetur në proces prej datës 05.05.2015 me 4 pasuri me sipërfaqe 7930 m² (2300 m² arë +3450 m² Pemëtore + 800 m² arë + 1380 m² Pemëtore); aplikuar për regjistrim dhe mbetur në proces prej datës 05.05.2015 pasuri të cilat krijojnë mbivendosje:

a. mbi pasurinë nr. 526/2, v.3, f. 118 zk. 1668, me sipërfaqe 7000 m², pronë e R. B.me origjinë përfituar me AMTP mbi të cilën **mbivendosen:**

a.1 pasuria nr. 526/7 zk. 1668 me sipërfaqe 800 m² arë me origjinë përfituar me AMTP nr.3, datë 10.3.2015 në emër të R. (M.) I. V.

a. 2. mbivendoset dhe pasuria me sipërfaqe 2300 m² arë zk. 1668 me origjinë përfituar me AMTP nr.1, datë 10.3.2015); si

b. Mbi pasurinë nr. 511/1, v3, f.29,zk.1668, me sipërfaqe (AMTP 3000 m² - LN 2850 m²) pronë e z. H.Xh.i tjetërsuar ne emër të N. Xh. me referencën nr. 39, datë 17.01.2008), **mbi të cilën mbivendoset në sipërfaqen** (një pjesë, papërcaktuar) pasuria tjetër me sipërfaqe totale 1380 m² Pemëtore me origjinë përfituar nga AMTP nr. 4, datë 10.3.2015, në emër të R. (M.) I. V.. Ky kufizim mbi gjithë pasuritë të zgjasë deri në verifikimin e titujve të pronësisë nga strukturat përkatëse.

Menjëherë

Rekomandim 24: ZVRPP Dibër, Regjistruesi të marrë të njoftoje Bashkinë Dibër, Njësinë Administrative Muhurr, (Komunen Muhurr) dhe KVVTP Prefekti Qarkut Dibër të prezantoje mbivendosjet dhe të kërkojë pavlefshmëri të titujve të pronësisë të AMTP-ve nr. 1, 3, 4, datë 10.3.2015 me 4 pasuri me sipërfaqe 7930 m² (2300 m² arë +3450 m² Pemëtore + 800 m² arë + 1380 m² Pemëtore) lëshuar në emër të R.(M.) I. V. i cili është trajtuar një herë me tokë bujqësore si pjesëtar i familjes I. M. V. me AMTP nr. 18246 me sipërfaqe 10954 m² dhe së dyti si anëtar i familjes sipas certifikatës nr. 007027177 lëshuar datë 05.03.2015 nga ZGJC Muhurr (pra certifikata nuk është gjendje v.1991, përmban persona të datëlindjeve 95,97,99 dhe 2004), fakte këto që në tejkalim të kompetencave, përbëjnë pavlefshmëri absolute të titujve të pronësisë, të cilat të deklarohen pranë KVVTP -së të pa deklaruara me parë, mosveprime në kundërshtim me ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë së Titujve mbi tokë bujqësore”.

Menjëherë dhe vazhdimisht

Gjetje 12: ZVRPP Dibër lidhur me regjistrimin e Pronave Publike të Transferuara, referuar tabelës “Tabela e inventarit me Treguesit teknik të Digave në Republikën e Shqipërisë” në 8 komuna me 22 rezervuar me sipërfaqe ujore teknike (truall) **686500 m²** prej tyre ka çelur 16 KPP me sipërfaqe **409562 m²** për 13 rezervuar me sipërfaqe më pak pra me diferencë **-276 938 m²dhe nuk ka regjistruar** 9 rezervuar prej të cilëve:

a. Nuk ka çelur KPP në 7 Komuna për 9 Rezervuar, me sipërfaqe ujore për -223000 m²

b. Për 2 rezervuar me sipërfaqe ujore teknike sipas inventarit të Digave 105000 m² ka çelur 5 KPP me sipërfaqe 133 853 m², pra ka çelur tepër 3 KPP me sipërfaqe tepër + 28 853 m²,(-105000+133853) përkatësisht: Për Rezervuarin Grezhdan me sipërfaqe teknike inventari 45000 m² ka çelur 3 pasuri KPP me sipërfaqe 29808 m² pra më pak-15192 m² , ndërsa për Rezervuarin Qenok, Melan me sipërfaqe teknike inventari 60000 m² ka çelur 2 pasuri KPP me sipërfaqe 104045 m², pra me sipërfaqe tepër +44045 m² (- 15192 m² + 44405 m²).

c. Çel KPP për 11 Rezervuar sipërfaqe ujore teknike 358 500 m² në sipërfaqen 275 509 m², me pak -82 991 m² ndarë: c.1. Janë çel KPP për 5 Rezervuar me sipërfaqe ujore teknike 255

500 m² në sipërfaqen 106 284 m², me pak -149 216 m², c.2.. Janë çel KPP për 6 Rezervuar me sipërfaqe ujore teknike 103000 m² në sipërfaqen 169 255 m², me tepër +66225 m². Nga sa sipër përveç pasaktësive në evidencimin dhe çeljen e KPP-ve, nuk ka regjistruar në pronësi të subjekteve publik (NJQV, Borde Kullimi, Bashki) asnjë prej 22 rezervuarve, të cilat i janë transferuar ish NJQV-ve Komunave, tani Bashkisë; pasqyruar në tabelat “**Gjendja e sipërfaqeve të Rezervuarve sipas Inventarit të Digave në R.Sh dhe sipas KPP të çelura dhe administruara nga ZVRPP Dibër Tabela nr 6.1**” dhe “**Gjendja e sipërfaqeve të Rezervuarve sipas Inventarit të Digave në R.Sh dhe sipas KPP të çelura administruara nga ZVRPP Dibër Sipas ish-Komunave Tabela nr. 6.2**”; mosveprime në kundërshtim me ligjin nr.33, datë 21.3.2012“Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe pikën 6, 7 të VKM nr. 567, datë 14.7.2010 “Për Transferimin e Rezervuarve dhe Skemave Ujitëse Përkatëse nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në Pronësi të Njësive të Qeverisjes Vendore dhe për një Ndryshim në Vendimin nr. 1157, datë 25.11.2009 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Listës së Inventarit të Pronave të Paluajtshme Shtetërore, të Bordeve të Kullimit, të cilat i Kalojnë në Përgjegjësi Administrimi Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit” (Trajtuar hollësisht në faqet 176-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 25: ZVRPP Dibër të marrë masa të çelë KPP-të të regjistrojë pronat publike të llojit rezervuar me Digat përkatëse, me skemat ujitëse, aksesoret përkatës rrjetet e Kanaleve të sipërm, shkarkues e të kanalit kryesor shpërndarës etj, dhe të kërkojë në rrugë zyrtare nga Bashkia Peshkopi, 8 ish-komuna NJQV-të dhe Bordit të Kullimit Dibër për aplikimin dhe regjistrimin e 22 rezervuarve me sipërfaqe ujore teknike (truall) **686 500 m²** sipas emërtesës referuar tabelës “Lista e Digave për Transferim” me treguesit përkatës teknik dhe të sipërfaqeve përcaktuar në tabelën emërtuar “Tabela me Treguesit e Digave” shtrire në 8 ish- Komuna, sipas pikën 6, 7 të VKM nr. 567, datë 14.7.2010 “Për Transferimin e Rezervuarve dhe Skemave Ujitëse Përkatëse nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në Pronësi të Njësive të Qeverisjes Vendore dhe për një Ndryshim në Vendimin nr. 1157, datë 25.11.2009 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Listës së Inventarit të Pronave të Paluajtshme Shtetërore, të Bordeve të Kullimit, të cilat i Kalojnë në Përgjegjësi Administrimi Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit”.

Menjëherë

Rekomandim 26: ZVRPP Dibër të marrë masa dhe të çelë KPP-të për 9 Rezervuar, me sipërfaqe ujore teknike për 223000 m², të pa çelura deri në momentin e auditimit, ndodhur në 7 Komuna të Rrethit Dibër,

b. Të çelë KPP e reja të sakta për 2 rezervuar me sipërfaqe ujore teknike 105000 m² përkatësisht KPP për Rezervuarin Grezhdan me sipërfaqe teknike inventari 45000 m² dhe KPP për Rezervuarin Qenok, Melan me sipërfaqe teknike inventari 60000 m² sipas inventarit të Digave; si dhe anulojë dhe mbyll 5 KPP të çelura parregullta e të pasakta me sipërfaqen e pasaktë 133 853 m², përkatësisht; 3 KPP çelur tepër me sipërfaqe tepër + 28 853 m², (-105000+133853) për rezervuarin Grezhdan dhe anulojë e mbyll 2 pasuri KPP të pa sakta me sipërfaqe 104045 m², pra me sipërfaqe tepër +44045 m² (-15192 m²+44405m²) për Rezervuarin Qenok, Melan i cili ka sipërfaqe teknike inventari 60000 m².

c. Të anulojë e mbyllë KPP-të e Çelura me sipërfaqe të pasakta për 11 Rezervuar sipërfaqe ujore teknike 358 500 m², çelur në sipërfaqen 275 509 m², me pak -82 991 m² ndarë: c.1. Janë çel KPP për 5 Rezervuar me sipërfaqe ujore teknike 255 500 m² në sipërfaqen 106 284 m², me pak -149 216 m², c.2.. Janë çel KPP për 6 Rezervuar me sipërfaqe ujore teknike 103000 m² në sipërfaqen 169 255 m², me tepër +66225 m²; si dhe të çelë KPP-të përkatëse të

sakta për 11 Rezervuar sipërfaqe ujore teknike 358 500 m², sipas tabelës “Tabela e inventarit me Treguesit teknik të Digave në Republikën e Shqipërisë” dhe skemave ujitëse përkatëse, pasqyruar në tabelat “**Gjendja e sipërfaqeve të Rezervuarve sipas Inventarit të Digave në R.Sh dhe sipas KPP të çelura dhe administruara nga ZVRPP Dibër Tabela nr 6.1**” dhe “**Gjendja e sipërfaqeve të Rezervuarve sipas Inventarit të Digave në R.Sh dhe sipas KPP të çelura administruara nga ZVRPP Dibër Sipas ish-Komunave Tabela nr. 6.2**”;

Menjëherë

Gjetje 13: Nga ana e ZVRPP Dibër janë pranuar e marrë në dorëzim dhe administrohen 16 KPP të çelura nga Njësia e Menaxhimit të Projektit për 13 rezervuar ndodhur në zonat e futura në sistem, ku në 2 raste pra për 2 rezervuar janë çelur 5 KPP, është lejuar pranuar KPP të çelura nga NJMP me ndryshime zërash kadastral përkatësisht: *zëri arë me 18250 m² nga zëri rezervuar ku përfshin 11000 m² rezervuar, pra ndryshuar zëri kadastral, tej kompetencave. Gjithashtu sipas PIII pasuria nr. 449, v.2, f. 20 zk 2019, me sipërfaqe 1010 Kacni rezulton Rezervuar, ndërsa sipas KPP çelur pasuria nr. 449, v.2, f. 20, me sipërfaqe 1010 m² është e llojit “Ledh”; pra është ndryshuar zëri kadastral nga rezervuar në “ledh” dhe nuk është shënuar sipërfaqja prej 120000 m² Rezervuar, pra më pak për -118990 m² rezervuar sipërfaqe ujore, veprime dhe mosveprime këto, në kundërshtim me të dhënat e Treguesve teknik të inventarit të Digave në Republikën e Shqipërisë dhe me VKM nr. 567, datë 14.7.2010 “Për Transferimin e Rezervuarve dhe Skemave Ujitëse Përkatëse nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në Pronësi të Njësive të Qeverisjes Vendore dhe për një Ndryshim në Vendimin nr. 1157, datë 25.11.2009 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Listës së Inventarit të Pronave të Paluajtshme Shtetërore, të Bordeve të Kullimit, të cilat i Kalojnë në Përgjegjësi Administrimi Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit”, pasqyruar në tabelën emërtuar “Gjendja e sipërfaqeve të Rezervuarve sipas Inventarit të Digave në Republikën e Shqipërisë” dhe sipas KPP të çelura dhe administruara nga ZVRPP Dibër” dhe në kundërshtim me ligjin nr.7843 ,datë 13.7.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe me ligjin nr.33, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” (Trajtuar hollësisht në faqet 176-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 27: ZVRPP Dibër të marrë masa për eliminimin e ndryshimit të zërit në 16 KPP KPP-të e çelura nga Njësia e Menaxhimit të Projektit për 13 rezervuar ndodhur në zonat e futura në sistem, ku për 2 rezervuar janë çelur 5 KPP, me ndryshime zërash kadastral përkatësisht: *zëri “arë” me 18250 m² nga zëri “rezervuar sipërfaqe Ujore” ku përfshin 11000 m² rezervuar, pra ndryshuar zëri kadastral, tej kompetencave,*
- Të mbyll KPP pasuria nr. 449, v.2, f.20 zk 2019, me sipërfaqe 1010 m²”Ledh”, që i përket Rezervuarit fshatit Kacni duke çelur KPP të re në sipërfaqen teknike të inventarit; si dhe të korrigjojë gabimin në PIII të shprehur: “PIII pasuria nr. 449, v.2, f. 20 zk 2019, me sipërfaqe 1010 m² rezervuar Kacni, duke fshirë këtë dhe të hedhë saktë të dhënat e KPP me nr., vol., në zërin kadastral “Rezervuar sipërfaqe ujore” me emërtimin “Rezervuari Fshati Kacni “ dhe në sipërfaqen teknike sipas inventarit të Digave.

Menjëherë

Gjetje 14: ZVRPP Dibër me referencat nr. 009501, datë 01.10.2010 janë kryer transaksione të parregullta e pasqyruar me mangësi në regjistrat hipotekor e KPP dhe me referencën nr. 009508, datë 05.10.2010, aplikim nr. 1420, datë 05.10.2010, me aplikues z. M. R. M. ZVRPP Dibër ka regjistruar kontratë shkëmbimi nr.9995 Rep. nr. 1212/2 kol. datë 04.10.2010, para noterit I.K., me palë *shitës-blerës* M.R.M. dhe *blerës-shitës* Bashkia Peshkopi me përfaqësues U.Z., autorizuar nga me kryetar z. I.K., me objekt shkëmbimin e pasurisë regj hip nr.146, datë

02.9.2010, KPP pasuria nr.9/77 (koregjuar 9/4/1) v.3,f.125 zk. 2392 truall me sipërfaqe **463 m²** ndodhur lagje “Gjok Doci” prone e M.R.M. me pasurinë regj hip nr.160, datë 01.10.2010, KPP pasuria nr.9/131 v.20, f.75, zk. 2392 Qytet Peshkopi me **sipërfaqe 612 m², lloji truall, ndodhur ne lagjen “Nazmi Rushiti”** prone e Bashkisë Peshkopi. Kjo kontratë është e pabarabartë në disfavor të Bashkisë Peshkopi favorizon qytetarin M.R.M por janë regjistruar vetëm pasuritë në emër të qytetarit dhe duke lënë në KPP përsëri në pronësi të tij edhe pronën e këmbyer prej 463m² truall, veprime këto në kundërshtim me nenin 21, “Bashkimet dhe ndarjet” të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994”Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, dhe me pikën 5.1 paragrafi II, Kreu VI të Rregullores nr. 184, datë 18.4.1999 “Për punën në zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, që kanë sjellë si pasojë në ndërmjet të tjerash përfitim të jashtë ligjshëm, të ardhura të munguara dhe dem ekonomik në vlerën **prej 9,665,000 lekë** si ardhur e munguar e dem ekonomik si nivel qiraje e pa llogaritur arkëtuar për Bashkinë Peshkopi nga përdorimi pa titull pronësie i sipërfaqes prej 430 m² truall (370 m² truall dhe 60 m² truall i ndërtesës) nga qytetari M.R.M. për një periudhë prej v.1992, llogaritur si nivel qiraje e pa llogaritur dhe e pa ndalur nga Bashkia, përberë nga:

a. Niveli i qirasë munguar nga përdorimi i truallit pa titull pronësie (përdorimi i truallit të bashkisë sipas lejes së ndërtimit nr. 494 Prot, VKRT Këshillit Rrethit nr. 4, datë 15.10.1992 sipas Genplanit bashkëlidhur ref. 004906 sipërfaqe e Sheshit prej 370 m² ku ndodhet dhe godina 60 m² që përdoret si pikë tregtimi karburanti)

Për sip. 370 m² x 100 lekë/m²/muaj x 215 muaj (4.10.2010-15.10.1992), = **7,955,000 lekë**; pra periudha prej marrjes së lejes ndërtimit deri në datën 4.10.2010 hartimin e Kontratës Këmbimit me Bashkinë.

b. Për sipërfaqen 60 m² truall i ndërtesës së depozitave të Pikës karburantit llogaritur: 60 m²x100 lekë/m²/muaj x 285 muaj (15.7.2016- 15.10.1992)= **1,710,000 lekë**; pra periudha prej marrjes së lejes ndërtimit deri në datën 15.7.2016 në momentin e auditimit si truall pa titull pronësie dhe i pa përfshirë në kontratën e këmbimit.

Llogaritjet për shfrytëzimin e truallit pa titull pronësie dhe përdorim pike karburanti janë kryer mbi bazën e pikës 4, Kreu III i VKM nr. 1712, datë 24.12.2008 , pikës 1/c Kreu III i VKM nr. 529, datë 8.6.2011 dhe pika 2 Kreu III VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për Përcaktimin e Kritereve të Procedurës të Mënyrës së Dhënies me Qira, Emfiteozë apo Kontratave të Tjera të Pasurive Shtetërore”, pra veprime dhe mosveprime në kundërshtim me ligjin nr.7843 ,datë 13.7.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe me ligjin nr.33, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”dhe me Rregulloren nr. 184, datë 18.4.1999, pasi kanë kryer regjistrime mbi pasuritë pa u zhveshur nga detyrimet apo barrët mbi to të rrjedhura nga përdorimi i pa ligjshëm e pa titull pronësie mbi truallin pronë e Bashkisë Peshkopi (*Trajtuar hollësisht në faqet 181-189 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 28: ZVRPP Dibër Regjistruesi, të njoftojë Bashkinë Peshkopi dhe qytetarin M.R.M të nxjerrë urdhër të veçantë ne bazë të neneve 50,60 dhe 74 për kufizimin në regjistrat hipotekor dhe në KPP të pasurive:

a Pasuria regjistruar në regjistrin hipotekor nr.160, datë 01.10.2010 truall 612 m², kaluar ne regjistrin hipotekor nr.165, datë 05.10.2010, në pronësi të Qytetarit M.R.M si dhe regjistruar në KPP pasuria nr. 9/131, v.20, f.75, zk. 2392 Qytet Peshkopi me sipërfaqe 612 **m² truall**, lëshuar certifikatë ne pronësi të Qytetarit M.R.M nga **kontrata e këmbimit** nr. 9995 Rep. nr. 1212/2 kol. datë 04.10.2010, ndërmjet Bashkisë dhe Qytetarit Mud Ramadan Mziu.

b. Pasuria regjistruar në regj hip nr.146, datë 02.09.2010, truall me sipërfaqe 463 m² truall kolona “Shënime transkriptimi” është bosh pra prona ende ndodhet në emër të M.R.M nuk ka shënim për kontratën e këmbimit pra dhe nuk është regjistruar në pronësi të Bashkisë: si dhe regjistruar në KPP pasuria nr.9/77 (korrigjuar 9/4/1) v.3,f.125 zk. 2932 truall me sipërfaqe 463 m² truall, mbetur ne pronësi te të Qytetarit M.R.M, duke mos e regjistruar këtë pasuri në pronësi të Bashkisë Peshkopi në kundërshtim me kontratën e këmbimit nr. 9995 Rep. nr.

1212/2 kol. datë 04.10.2010, ndërmjet Bashkisë dhe Qytetarit M.RM . Kufizimi të zgjasë deri në shlyerjen detyrimit ndaj Bashkisë Peshkopi në vlerën **prej 9,655,000 lekë** si ardhur e munguar e dëm ekonomik për Bashkinë Peshkopi nga përdorimi pa titull pronësie i sipërfaqes prej 430 m² truall (370 m² truall dhe 60 m² truall i ndërtesës) nga qytetari M.RM

c. ZVRPP Dibër Regjistruesi, të njoftojë Bashkinë Peshkopi dhe qytetarin M.RM , lidhur me urdhër kufizimin, detyrimin dhe dëmin ekonomik, rrjedhur nga kontratën e këmbimit nr. 9995 Rep. nr. 1212/2 kol. datë 04.10.2010, ndërmjet Bashkisë dhe Qytetarit M.RM ,

Menjëherë

Gjetje 15: ZVRPP Dibër me referencën nr. 0011542, datë 25.03.2013, aplikim nr. 348, datë 27.2.2013 në Postës Shqiptare sh.a, Dega Peshkopi ka pranuar e kryer regjistrim të vonuar të pasuritë ndërtesa e troje të Kësaj Dege dhe ka lëshuar vërtetimet hipotekore nr. 69 dhe nr.70, datë 04.04.2013, bazuar në VKM nr.363, datë 11.06.2004 “Për Miratimin e Listës së Inventarit të Pronave të Paluajtshme Shtetërore, të Cilat Kalojnë në Përgjegjësi Administrimi “P.Sh” SHA-së”. Në këtë aplikim ZVRPP Dibër nuk ka llogaritur e ndalur ndaj P.Sh. sh.a, Dega Peshkopi vlerën prej **300,000 lekë** të kamatë vonesës për regjistrim të vonuar prej mbi 8,5 vjet (27.02.2013-11.07.2004), që përbën dëm ekonomik dhe të ardhura të munguara për ZVRPP Dibër, në kundërshtim me nenin 39 të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 “Për Regjistrim in e Pasurive të Paluajtshme”, ku shprehet:”... *paraqitja me vonesë, përveç tarifës së regjistrimit për çdo dite vonese që ka kaluar paguhet kamatë vonesë e barabartë me 10% të tarifës së regjistrimit por jo më shumë se 300 000 lekë*”, llogaritur: 10% x 7000 lekë x 3146 ditë (22.07.2013-11.07.2004) = 2202200 lekë) (Trajtuar hollësisht në faqet 181-189 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 29 : ZVRPP Dibër, Regjistruesi të analizojë nxjerrë përgjegjësinë e zhdëmtojë vlerën prej **300,000 lekë** të kamatë vonesës dhe të marrë masa e të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të ligjit nr. 33/2012, datë 29.4.2012”Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 5 pika 1, neni 59, 60, 74 deri në likuidimin e vlerës prej **300,000 lekë**, përkatësisht :

Ndaj pasurive ndërtesa e troje të P.Sh. sh.a, Dega Peshkopi, regjistruar në hipotekë zk 2932 sa lëshuar vërtetimet hipotekore nr. 69 dhe nr.70, datë 04.04.2013.

Menjëherë

Gjetje 16: ZVRPP Dibër për periudhën 2013-2015 dhe në periudha më parë ka pamjaftueshmëri pune lidhur me:

1. Administrimin e praktikave dhe kërkesave në proces të pa përfunduara në pritje prej 5 vitesh ku për periudhën para vitit 2013 nuk ato evidentohen, ndërsa për v. 2014-2015 evidentohen **66 praktika** të papërfunduara me të ardhura të përfituara pa dhënë shërbimin e faturuar përkatësisht nga **300,1 mijë lekë** sipas tarifave deri në **883 mijë lekë** sipas Mandat arkëtimeve (përfshirë këtu dhe KVM dhe transaksione të tjera) , pa aktverifikime AV dhe pa dokumentacionin procedural justifikues të qëndrimit në proces (praktika të ndodhura në ambientet e arkivës dhe të zyrave) të pa inventarizuara dhe pa dorëzuara, nga specialistët, për të cilat për 10 janë dhënë përgjigje ndërsa për 54 nuk ka përgjigje në kundërshtim e ligjin nr. 9154, datë 6.1.1993 “Për arkivat” dhe me **Rregulloren nr. 2079, datë 11.6.2007 “Për arkivimin e dokumenteve tekniko ligjore ne ZRPP”**, pasqyruar në tabelën emërtuar “**Tabele përmbledhëse e praktikave në proces para v. 2012 dhe periudha 2013-2015 ZVRPP Dibër**”,nxjerrë nga tabela analitike emërtuar ”**Praktika në proces të papërfunduara ndodhur tek specialistet deri vitin 2015**”.

2. Pamjaftueshmëri e bazës nënligjore aktuale, në përmbushje të rritjes së transparencës së zyrës lidhur me shërbimin ndaj publikut dhe forcimit të Sistemit të Kontrollit të Brendshëm lidhur me integritetin e punonjësve në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për

Mekanizmin Financiar dhe Kontrollin”, lidhur me mungesën e një rregullore të brendshme të Funkcionimit të Administratës së ZVRPP Kavajë, të miratuar nga Kryeregjistruesi për periudhën e mëparshme dhe për vitet 2011-2013, lidhur me faktin që Rregullorja aktuale nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, e cila është ende ajo e viteve 1999, e shoqëruar me ndryshime të pjesshme, përveç se duhet përmbledhur e bërë e plotë, por nuk ka si objekt funksionimin e Administratës së ZVRPP, si njësi e vetme në territorin vendor dhe në kushtet e reja të përditësimit, pra nuk është e përshatur me kërkesat e ligjeve nr. 9936, datë 26.6.2008, dhe zbatimit të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” ,

3. Për pasojë nuk ka një përcaktim të kryerjes së detyrave lidhur me përgatitjen e evidencave informacionit në tërësi, shërbimit të IT dhe sidomos lidhur me trajtimin dhe ndjekjen e ankesave kërkesave të qytetarëve, me mënyrën e marrjes së shërbimit të ofruar qytetarëve nga kjo zyrë, si dhe lidhur me vjeljen e opinionit të tyre për cilësinë afatin e shërbimit dhe sidomos lidhur me evidentimin tërësor, raportimin e praktikave në proces evidentimin e afateve të zgjidhjes së tyre, nxjerrjen e përgjegjësisë së zgjatjes dhe shkeljes së afateve, evidentimin dhe ndjekjen periodike të zgjidhjes së pronave të regjistruara me mbivendosje, trajtimin dhe përgjigjen e ankesave etj.,pra mungon instalimi i Sistemit të Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB), në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” (*Trajtuar hollësisht në faqet 189-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 30: ZVRPP Dibër, Regjistruesi të marre masat për inventarizimin e dokumentacionit, identifikimin e tyre para viteve 2013 dhe të evadohen aplikimet e **66** praktikave dhe kërkesave në proces të pa përfunduara prej 5 vitesh deri ne vitet 2015, të analizohen dhe kthehen të ardhurat e përfituara pa dhënë shërbimin e faturuar përkatësisht **300,1 mijë lekë** sipas tarifave deri në **883 mijë lekë** sipas Mandat arkëtimeve, që kanë sjellë si pasojë mungesën e transparencës së punës së ZVRPP Dibër ndaj publikut, dhe të administrohen në arkiv dokumentacioni përkatës i praktikave, në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 6.1.1993 “Për arkivat”, neni 24, germa “b” dhe të neneve 4 e 5, Kapitulli II-të, për “Detyrat e Sekretar-Arkivit të organit shtetëror” dhe “Rregullores për punën me dokumentet administrative të organeve shtetërore”, ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, rregullores nr. 2079, datë nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, sipas tabelës “**Përmbledhëse e praktikave në proces para v. 2012 dhe periudha 2013-2015 ZVRPP Dibër**”, dhe tabelës analitike “**Praktika në proces të papërfunduara ndodhur tek specialistet deri vitin 2015**”.

Menjëherë

Rekomandim 31: ZQRPP dhe ZVRPP Dibër të ndjekin hapat e duhur ligjor për instalimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të vendosin Sistemin e Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB) si dhe të hartojnë, miratojnë e zbatojnë Rregulloren e brendshme të Funkcionimit të Administratës së ZVRPP Dibër, si njësi e vetme në territorin vendor, bazuar ne organikat dhe organigramën dërguar nga Kryeministri me urdhrat nr. 196, datë 4.8.2014 “Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Urdhrin nr. 33, datë 2.4.2013 të Kryeministrit”. Në Rregullore të përfshihen, përcaktohen, shkruhen, kushtet e pranimit, testimi fillestar të aftësive profesionale dhe trajnimit në vazhdim të punonjësve në ZVRPP, statusi i të punësuarve, përcaktimi i kryerjes së detyrave, ushtrimi i kompetencave dhe mbajtja e përgjegjësive për secilin specialist, Regjistruesi, zv .Regjistruesi juristëve dhe punonjës të tjerë, si dhe detyrimet lidhur me përgatitjen e evidencave informacionit në tërësi dhe administrimin e dokumentacionit; si dhe për të gjitha këto procese dhe të punësuar të përcaktohen e vendosen SMKB (*Sistemit të Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm*) masa

këto të detyrueshme në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Menjëherë

Gjetje 17: ZVRPP Dibër në **12 raste**, ka regjistruar Aktet e Marrjes së Tokës në Pronësi në disa ZK të rrethit Peshkopi, nëpërmjet shkresave të komunave Melan, Kala e Dodës, Luzni dhe Muhur për 27 AMTP për fshatrat Bugjenec, Grevë, Hotesh, Çerene dhe Hudhë Muhur, me një sipërfaqe prej 72.057 m² tokë bujqësore për regjistrim fillestar dhe fitimin e titullit të pronësisë për kalimin e akteve nga përdorim në pronësi, të miratuara me vendim të Këshillit të Komunave, sipas kërkesave të banorëve të juridiksionit të çdo komune për fshatrat Bugjenec, Grevë, Hotesh, Çerene dhe Hudhë Muhur, në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 57/2012, datë 17.05.2012 “Për përfundimin e procesit të kalimit në pronësi, të përfituesve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore” dhe VKM nr. 222, datë 6.3.2013 “Për përcaktimin procedurave të kryerjes të procesit të kalimit në pronësi, të përfituesve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore”, për të cilat në praktikën dokumentare mungonin: regjistri i akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, afishimi për çdo rast të shqyrtimit në vende të dukshme, shkresat nga zyrat përkatëse për informacionin në lidhje me pronën që do të jepet në pronësi, botimi në fletoret zyrtare dhe procedurat e tjera të miratimit nga ZAMT pranë Këshillit të Qarkut apo Prefektura përkatëse, nuk ka të përcaktuar origjinën e sipërfaqes së tokës që ndahet, nga fondi i tokës së pandarë apo të refuzuar, nuk ka analizë për sipërfaqen e përfituar duke argumentuar se nuk është plotësuar norma për frymë sipas përbërjes familjare 1 gusht 1991, nuk ka përshkrim që kjo sipërfaqe toke është e lirë dhe nuk posedohet prej dikujt, nuk është verifikuar që për këto persona ka AMTP apo në përdorim, të plotësuar nga ish-komisionet e ndarjes së tokës në fshat si dhe regjistrimin e tyre. Ndërsa në një rast sipas aplikimit nr. 558, datë 27.01.2014, nuk është prerë aplikim për shërbimin e HTR-së për 9 pasuri x 1000 lekë e barabartë me **9,000 lekë që përbën dëm ekonomik**, (Trajtuar më hollësisht në faqet 26-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 32: ZVRPP Dibër të mos kryejë regjistrimin e Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi, lidhur me regjistrimin e titullit të pronësisë nga në përdorim që kanë qenë, duke kërkuar nga Bashkia, njësitë administrative të saj, plotësimin e dokumentacionit për procedurat e ndjekura në lidhje me përfitimit të titullit të pronësisë.

Të verifikohen në ZAMT të ish-Komunave Melan, Kala e Dodës, Luzni dhe Muhurr qarku Dibër mbi zbatimin e procedurave ligjore të përfitimit të titullit të pronësisë për 27 rastet e nisura për regjistrim në ZVRPP Dibër, sipas shkresave të këtyre komunave.

Vazhdimisht

Gjetje 18: ZVRPP Dibër për vitin 2013 ka pranuar e regjistruar **73 leje ndërtimi objektësh** mbi truall shtetëror e privat, me mangësi në formë e përmbajtje të dokumentacionin përbërës, prej të cilave në **65 leje** sheshi ndërtimi të lëshuara nga Bashkia në vitet 1997-2011 mbi truall publik në sipërfaqen **4970 m²**, dërguar për regjistrim te objekteve për periudhën janar - dhjetor 2013 paraqitur në tabelën emërtuar “Regjistrimi i Lejeve të Ndërtimit lëshuar në troje publike nga Bashkia pa Marrëdhënien e Truallit dhe Efekti i vlerës së Truallit dhe Vlera e Qirasë së Akumuluar Viti 2013”, duke mos refuzuar e kthyer dokumentacionin e mangët, mos kërkuar ndaj Bashkisë Dibër zgjidhjen e marrëdhënies së truallit me pasojë detyrimet e rrjedhura në vlerën **18,299,233 lekë** vlerë trualli (llogaritur sipas VKM dhe vlera prej **29,003,930 lekë** nivel qiraje nga përdorimi dhe zënia me ndërtim pa titull pronësie, për të cilat ZVRPP Dibër nuk ka vendosur as barrë mbi pronë mbi pasuritë ndërtimore të paktën në vlerën përkatëse të qirasë së përdorimit, duke shkaktuar demin ekonomik të mësipërm për buxhetin e Bashkisë; në kundërshtim me nenet 30, 32 të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për Urbanistikën”, i ndryshuar, me nenin 13 të ligjit nr 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe

Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, ne kundërshtim me UKM nr.3, datë 15.2.2001 i ndryshuar “Për Kontrollin dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”, me ndryshime, në kundërshtim me kreun IV pikat 12.1-7 të Rregullores nr. 184, datë 18.4.1999 “Për Punën në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, në kundërshtim me nenin 46, pikat 1-5 të ligjit nr.33, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, dhe në pikën 4 ku shprehet: “...Regjistruesi informon brenda 10 ditëve organet e administratës tatimore për regjistrimin e lejes së ndërtimit...” dhe në bazë të ligjit 33/2012 nenit 23 ku shprehet: “...Regjistruesi dhe çdo punonjës tjetër i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme mbajnë përgjegjësi ligjore për veprimet dhe aktet e lëshuara prej tyre”(Trajtuar në faqet 59-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 33: ZVRPP Dibër, Regjistruesi të nxjerrë urdhër të veçantë të vendosë barrë mbi pronën në seksionin “D” të KPP-ve ZK. 2932 Qytet dhe në Regjistrat Hipotekore në vlerën **18,299,233 lekë** vlerë truall (llogaritur sipas VKM) dhe vlera prej **29,003,930 lekë** nivel qeraje nga përdorimi dhe zënia me ndërtim pa titull pronësie, mbi pasuritë e llojit ndërtesa nga **65 leje** sheshi ndërtimi të lëshuara nga Bashkia në vitet 1997-2011 mbi truall publik në sipërfaqen **4970 m²**, dërguar për regjistrim te objekteve në periudhën për periudhën janar-dhjetor 2013, të regjistruara pa marrëdhënie truall dhe me dokumentacion të parregullt deri në likuidimin e detyrimeve ndaj Bashkisë Peshkopi dhe zgjidhjen ligjore të pronësisë mbi truallin; si dhe të njoftojë e ti kërkojë Bashkisë Peshkopi zbatimin e procedurave ligjore dhe kontratore rrjedhur nga lejet e shesheve, dhënia e lejeve të përdorimit të ndërtesave deri në heqjen e barrëve mbi këto pasuri, paraqitur në tabelën emërtuar “Regjistrimi i Lejeve të Ndërtimit lëshuar në troje publike nga Bashkia pa Marrëdhënien e Truallit dhe Efekti i vlerës së Truallit dhe Vlera e Qirasë së Akumuluar Viti 2014”.

Brenda 15 Dhjetor 2016

Gjetje 19: ZVRPP Dibër për vitin 2013 ka pranuar e regjistruar **2 leje ndërtimi pallate** nga të cilët njëra pjesërisht mbi truall shtetëror e privat, me mangësi në formë e përmbajtje të dokumentacionit përbërës dhe nuk janë regjistruar në rubrikën “Përshkrimi i veçantë” dhe kornizën “Për pjesën e përbashkët” për pallatin në tërësi dhe për çdo aksesor të tij (shesh pushimi, shkallë, depozita uji, sistem ngrohje etj). Pra nuk janë llogaritur e ndalur taksa e kalimit të pronësisë ndaj Investitorit Astrit Ademi, për sipërfaqen totale të përbashkët prej 80 m² në vlerën prej **24,000 lekë** (80 m² x 300 lekë/m²/ndërtim) dhe subjekti “A.& G.” shpk, për sipërfaqen totale të përbashkët prej 297.24 m² në vlerën prej **89,172 lekë** (297.24 m² x 300 lekë/m²/ndërtim) (sipas planimetrive të objektit, pjesë e dosjes), vlera prej 113,172 lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit pasi është mosveprim në kundërshtim me ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme neni 50, “**Regjistrimi i mjediseve të përbashkëta në ndërtesa**”, “pika 2, ku shprehet: “... Për efekt të regjistrimit, do të konsiderohen në pronësi të përbashkët të pronarëve të njësive individuale, në përputhje me kuotën e pjesëmarrjes në bashkëpronësi, të gjitha pjesët e një prone në bashkëpronësi, përveç njësisë, e cila është në pronësi individuale dhe në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.1996 “Për Sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar neni 28, “**Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme**”, pika 2 ku shprehet se: “... Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit pronësia e së cilës transferohet. Mos veprime që nuk i janë ndalur investitorëve qysh në regjistrim, pasi në rastin kur apartamentet dhe njësitë i shiten qytetarëve përfshijnë në çmim dhe vlerën e këtyre ambienteve të përbashkëta;

Në lidhje me regjistrimin e 2 pallateve përveç mangësive të trajtuara del se vlera e aplikuar për shërbimin e kërkuar është prerë tarifa 5000 lekë, nga 6500 lekë që duhet sipas listës së shërbimeve “Regjistrim Përfundimtar i ndërtimeve të reja” në zbatim të urdhrat e përbashkët nr. 5341/5, datë 07.09.2012 të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave “Për

miratimin e tarifave të shërbimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, pra 56 regjistrime x 1,500 lekë më pak për çdo rast = **84,000 lekë si dhe mos prerje aplikimi për 3 raste me vlerë 27,000 lekë në total 111,000 lekë që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik..**

*Gjithashtu në një rast nuk janë vendosur barrë mbi pronën në seksionin “D” të KPP-ve, në ZK.2932 Qytet dhe në Regjistrat Hipotekore në vlerën **423,088 lekë** vlerë trualli (llogaritur sipas VKM dhe vlera prej **359,600 lekë** nivel qiraje nga përdorimi dhe zënia me ndërtim pa titull pronësie, mbi pasuritë e llojit pallat me leje ndërtimi dhe sheshi ndërtimi të lëshuara nga Bashkia në 2011 mbi truall publik në sipërfaqen **124 m²**, për pasurinë nr. 14/225-ND, volum 26, faqe 47, dërguar për regjistrim te objekteve për vitin 2013, të regjistruara pa marrëdhënie trualli dhe me dokumentacion të parregullt deri në likuidimin e detyrimeve ndaj Bashkisë Peshkopi dhe zgjidhjen ligjore të pronësisë mbi truallin; si dhe të njoftojë e ti kërkoje Bashkisë Peshkopi zbatimin e procedurave ligjore dhe kontratore rrjedhur nga lejet e shesheve, dhënia e lejeve të përdorimit të ndërtesave deri në heqjen e barrëve mbi këto pasuri, paraqitur në tabelën emërtuar Regjistrimi i Lejeve të Ndërtimit lëshuar në troje publike nga Bashkia pa Marrëdhënien e Truallit dhe Efekti i vlerës së Truallit dhe Vlera e Qirasë së Akumuluar Viti 2013(Trajtuar në faqet 82-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 34: ZVRPP Dibër, Regjistruesi të nxjerrë urdhër të veçantë të vendosë barrë mbi pronën në seksionin “D” të KPP-ve, në ZK.2932 Qytet dhe në Regjistrat Hipotekore në vlerën **423,088 lekë** vlerë trualli (llogaritur sipas VKM dhe vlera prej **359,600 lekë** nivel qiraje nga përdorimi dhe zënia me ndërtim pa titull pronësie, mbi pasuritë e llojit pallat me leje ndërtimi dhe sheshi ndërtimi të lëshuara nga Bashkia në 2011 mbi truall publik në sipërfaqen **124 m²**, për pasurinë nr. 14/225-ND, volum 26, faqe 47, dërguar për regjistrim te objekteve për vitin 2013, të regjistruara pa marrëdhënie trualli dhe me dokumentacion të parregullt deri në likuidimin e detyrimeve ndaj Bashkisë Peshkopi dhe zgjidhjen ligjore të pronësisë mbi truallin; si dhe të njoftojë e ti kërkoje Bashkisë Peshkopi zbatimin e procedurave ligjore dhe kontratore rrjedhur nga lejet e shesheve, dhënia e lejeve të përdorimit të ndërtesave deri në heqjen e barrëve mbi këto pasuri, paraqitur në tabelën emërtuar “Regjistrimi i Lejeve të Ndërtimit lëshuar në troje publike nga Bashkia pa Marrëdhënien e Truallit dhe Efekti i vlerës së Truallit dhe Vlera e Qirasë së Akumuluar Viti 2013”.

Menjëherë

Gjetje 20: ZVRPP Dibër në **15 raste**, ka regjistruar kontrata shitblerje të trojeve nga Ministria e Financave, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike me një sipërfaqe prej 1102.90 m², ku në nenin 7 të çdo kontrate përcaktohet si bazë ligjore ligji nr. 10270, datë 22.04.2010 “Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksën mbi të drejtën e përdorimit të tij”, UMF nr. 30, datë 07.09.2010 Për zbatimin e ligjit nr. 10270, datë 22.4.2010 dhe VKM nr.738, datë 8.9.2010, që shpreh: DASHPP, kryen edhe shitjen e trojeve të ndërmarrjeve e objekteve të tjera shtetërore, të privatizuara para krijimit të këtyre agjencive, si dhe të truallit të ndërtesave, të ndërtuara në bazë të lejeve të ndërtimit, të lëshuara nga ish-komitetet pluraliste të këshillave, në periudhën e funksionimit të tyre, sipas gen planeve në kohën e lëshimit të lejes së ndërtimit”, për rastin konkret këto leje ndërtimi janë miratuar nga KRRT e Bashkisë Peshkopi, pas viteve 2004 dhe jo leje të miratuara nga ish komitetit pluralist Peshkopi, veprim në kundërshtim me pikën “c” të nenit 2 të ligji nr. 10270, datë 22.04.2010. Sa sipër në asnjë nga pikat a, b, c, të nenit 2, të ligjit nuk përcakton privatizimin e truallit në lidhje me objektin me leje ndërtimi nga KRRT-ja e Bashkia Peshkopi, të miratuara në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën”, i ndryshuar. Në këtë ligj, janë përcaktuar rregullat e veçanta për ndërtimet

publike dhe private në territorin e Republikës së Shqipërisë, i cili përcakton se në nenet 30 dhe 32 para miratimit të lejes së sheshit dhe lejes së ndërtimit duhet të paraqiten marrëdhëniet me truallin, ndërsa në nenin 55, mënyra e pagesës së vlerës së truallit.

Në zbatim të nenit 4, të ligjit nr. 10270, datë 22.04.2010, ZVRPP Dibër, duhet të kërkonte nëse subjekti ndërtues shlyerjen e detyrimit mbi përdorimin e truallit shtetëror në masën 10 % të vlerës së truallit, duke iu referuar harta përkatëse të vlerës së trojeve, e miratuar me VKM, në përputhje me dispozitat e ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronës, veprim në papajtueshmëri me neni 42, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 114-119 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 35: Regjistruesi i ZVRPP Dibër të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi në ZK nr. 2932 për pasuritë nr. 9/137, volum 26, faqe 26; nr. 4/37, volum 26, faqe 40; nr. 12/133, volum 9, faqe 117; nr. 11/154 ND, volum 25, faqe 167; nr. 4/33/1, vërt hip nr. 215, datë 04.07.13; nr. 13/17, vërt hip nr. 29, datë 30.01.13; nr. 5/335, vërt hip nr. 261, datë 06.08.13; nr. 22/44, vërt hip nr. 348, datë 06.08.13; nr. 22/269, vërt hip nr. 357, datë 16.09.13; nr. 22/214, vërt hip nr. 368, datë 03.10.13; nr. 23/83, vërt hip nr. 369, datë 03.10.13; nr. 23/33, vërt hip nr. 403, datë 03.10.13 dhe nr. 13/189, vërt hip nr. 403, datë 03.10.13, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajit Dhjetor 2016

Gjetje 21: ZVRPP Dibër në **17 raste**, ka regjistruar leje legalizimi në disa ZK të rrethit Peshkopi, duke mos verifikuar elementët e përmbajtjes së Aktit Administrativ dhe VKM, mbi bazën e të cilëve janë miratuar parcelat ndërtimore dhe ndërtimet informale dhe konkretisht:

Të gjitha referencat e audituara doli se duhej të ishin refuzuar për sigurimin e dokumentacionit të trajtuar me mungesë si: - ortofoto dixhitale data e fotografimit, harta e përditësimit, sipas kufizimeve të parcelës ndërtimore nuk ka rrugë hyrje në objekt, nuk është bërë bashkimi i truallit me objektin dhe nuk është bërë ndarja e pasurisë në arë në dy kartela, veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Rregulloren e punës së ZVRPP nr. 184, datë 08.04.1999 “Për Punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, me ndryshime dhe Udhëzimin metodik nr. 76, datë 13.09.1999 “Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme”, etj trajtuar rast pas rasti, veprime në papajtueshmëri me pikën 5 neni 44 e neni 49, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe Udhëzimin e Kryeregjistruesit nr. 2532, datë 21.04.2009, Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të fituar sipas ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 141- 148 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 36: Regjistruesi i ZVRPP Dibër të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi në ZK nr. 1224 për pasuritë nr. 2/3, volum 3, faqe 45; nr. 166/5/1, volum 3, faqe 9; nr. 49/1, volum 3, faqe 6; nr. 49/2, volum 3, faqe 7; nr. 21, volum 1, faqe 223; nr. 32/2, volum 3, faqe 25; ZK nr. 1225, pasuritë nr. 54/1, volum 2, faqe 104; nr. 62, volum 1, faqe 72; ZK nr. 1320, pasuritë nr. 41/255, volum 6, faqe 23; nr. 4/1/3, volum 6, faqe 24; ZK nr. 2384, për pasuritë nr. 206, volum 2, faqe 83; nr. 60/32, volum 4, faqe 19; nr. 182, volum 2, faqe 160; nr. 229/1, volum 4, faqe 32; ZK nr. 1859, për pasuritë nr. 127/13, volum 1, faqe 72; nr. 4/3, volum 4, faqe 102 dhe nr. 4/4, volum 2, faqe 15, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajit Dhjetor 2016

Gjetje 22: ZVRPP Dibër në **2 raste**, ka regjistruar, në ZK 2932, vendime në zbatim të nenit 25/b, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe VKM nr. 745, datë 24.10.2012 “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen”, me një sipërfaqe **trualli 559 m²** dhe sipërfaqe **ndërtesash prej 222 m²**, për të cilat mungojnë:

- nuk ka urdhër regjistruesi për krijimin e komisionit për hartimin e relacionit të kërkesës dhe për rrjedhojë nuk ka relacion nga grupi punës për verifikimin e pronës;
- relacionet për verifikimin në vend të kërkesave qytetare nga grupi i punës, për të cilat duhej të dokumentoheshin me pagesën për këtë qëllim.

- nuk ka shpallje për 45 ditë të pasurive, që të jetë e dokumentuar me procesverbal

- nuk ka përputhje të kufizimeve si dhe të konfiguracionit sipas fragmentit të HTR-së të dërguar nga Bashkia Peshkopi (*Trajtuar më hollësisht në faqet 157-161 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 37: Regjistruesi i ZVRPP Dibër të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi në ZK nr. 2932 për pasuritë nr. 18/16, volum 26, faqe 44 dhe pasuria nr. 20/253, volum 26, faqe 92, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajit Dhjetor 2016

Gjetje 23: ZVRPP Dibër në **8 raste**, ka regjistruar, në ZK 2932, vendime në zbatim të kërkesave të VKM nr. 608, datë 05.09.2012 “Për Përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri 10.08.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre”, Bashkia Peshkopi ka shqyrtuar kërkesat respektive të qytetarëve, duke miratuar kalimin e pronësisë të pasurisë së paluajtshme, të ndërtuar deri më datë 10.08.1991, nga të cilat **në 5 raste ka dhënë sipërfaqe 358 m², më tepër** se kërkesat e nenit 6 të Dekretit 7011, viti 1985 që përcakton nga data 08.01.1986 deri më 10.08.1991 në qytete jepet sipërfaqja deri 150 m² dhe konkretisht për pasuritë si më poshtë:

- vërtetimi hipotekor nr. 243, datë 30.07.2013, për pasurinë nr. 20/209, me sipërfaqe 178 m² truall+ndërtesë 1 kat, sipas vendimit nr. 10, datë 17.06.2013 të Bashkisë Peshkopi, regjistruar në mënyrë sporadike veprimet janë kryer në KPP volum 26, faqe 150, me referencë nr. **011652**.

- vërtetimi hipotekor nr. 244, datë 30.07.2013, për pasurinë nr. 28/41, me sipërfaqe 170 m² truall+ndërtesë 2 kat, sipas vendimit nr. 12, datë 17.06.2013 të Bashkisë Peshkopi, në mënyrë sporadike veprimet janë kryer në KPP volum 26, faqe 243, sipas referencë nr. **011678**

- vërtetimi hipotekor nr. 263, datë 09.08.2013, për pasurinë nr. 26/23, me sipërfaqe 260 m² truall+ndërtesë 2 kat, ndërtimi 110 m², sipas vendimit nr. 11, datë 17.06.2013 të Bashkisë Peshkopi, në mënyrë sporadike veprimet janë kryer në KPP volum 27, faqe 11, sipas referencë nr. **011705**.

- vërtetimi hipotekor nr. 410, datë 1.10.2013, për pasurinë nr. 24/83, me sipërfaqe 250 m² truall+ndërtesë 2 kat, miratuar me vendim nr. 20, datë 30.09.2013 të Bashkisë Peshkopi, në mënyrë sporadike veprimet janë kryer në KPP volum 27, faqe 61, sipas referencë nr. **011811**.

- vërtetimi hipotekor nr. 433, datë 04.11.2013, për pasurinë nr. 35/271, me sipërfaqe 250 m² truall+ndërtesë 1 kat, ndërtimi 100 m². miratuar me vendim nr. 19, datë 30.09.2013 të Bashkisë Peshkopi, në mënyrë sporadike veprimet janë kryer në KPP volum 27, faqe 79, sipas referencë nr. **011852**, veprimet janë në kundërshtim me nenin 6 të Dekretit 7011, të vitit 1985 që përcakton se nga data 08.01.1986 deri në 10.8.1991, në fshatra fushor deri 200 m², në fshatra kodrinore deri 250 m², në fshatra malore 300 m² dhe në qytete deri 150 m², (*Trajtuar më hollësisht në faqet 161-172 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 38: Regjistruesi i ZVRPP Dibër të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi në ZK nr. 2932 për pasuritë nr. 2/3, volum 3, faqe 45; nr. 20/209, volum 26, faqe 150, nr. 28/41, volum 26, faqe 243, nr. 26/23, volum 27, faqe 11, nr. 24/83, volum 27, faqe 61 dhe nr. 35/271, volum 27, faqe 79, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajit Dhjetor 2016

Gjetje 24: Në 2 raste në regjistrimin e vendimeve të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave janë shfaqur mangësi në regjistrimin vendimeve pasi nuk janë verifikuar elementët e formës dhe përmbajtjes, nuk është plotësuar shtojca nr. 3, si dhe nuk është marrë konfirmimi nga Agjencia e Trajtimit të Pronave nëse për këto vendime ka pasur ankimime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”(Trajtuar më hollësisht në faqe 10-14 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 39: Nga ZVRPP Dibër në çdo rast të regjistrimit të Vendimeve të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në të cilat nuk përcaktohet njoftimit i Avokaturës së Shtetit si palë e tretë për vendimin e marrë, të kërkohet konfirmimi nga Agjencia e Trajtimit të Pronave nëse për këto vendime ka pasur ankimime apo vendime të tjera që i rrëzojnë ato, gjithashtu duhet kontrollohen elementët e formës dhe përmbajtjes në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit” si dhe të plotësohet shtojca përkatëse.

Në vazhdimësi

Gjetje 25: Në 3 raste janë shfaqur mangësi në pranimin e dokumentacionit dhe regjistrimin e pasurive përfituar sipas VKM nr. 578, datë 29.08.2012 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit në pronësi të oborreve në përdorim”, të ndryshuar. Vendimet e AKKP-së në të 3 rastet janë marrë në kundërshtim me pikën 1, të VKM nr. 578, datë 29.08.2012, pasi në dokumentin e pronësisë nuk është bërë shënimi “Oborr në përdorim”, por përkundrazi kjo pasuri është e llojit truall e regjistruar në pronësi shtet. Në asnjë prej referencave nuk është plotësuar shtojca nr. 3, në kundërshtim me pikën 5, të VKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

-Vendimet e AKKP-së bien në kundërshtim me aneksin nr. 1, të VKM nr. 578, datë 29.08.2012 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit në pronësi të oborreve në përdorim”, ndryshuar me VKM nr. 790, datë 14.11.2012, pasi sipërfaqet e tjetërsuara si oborr në përdorim për qytetin janë mbi normën 150 m² përcaktuar sipas nenit 6, të Dekretit nr. 7011, të vitit 1985. Nga ana e ZVRPP Dibër nuk duhet të procedohej me regjistrimin, por duhet ti kërkonte Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë, **korrigjimin e vendimit për sipërfaqet mbi normën 150 m² të miratuar për “Oborr në përdorim”, në zbatim të akteve nënligjore të dala në zbatim.** Si pasojë e këtyre veprimeve personat kanë përfituar padrejtësisht sipërfaqen **prej 769 m²**, për pasuritë nr. 10/65, vol 18, fq. 33, zk. 2932, nr. 24/2, vol. 1, fq. 61, zk. 2932 dhe nr. 22/4, vol. 19, fq. 145 zk. 2932.

-Në 2 raste me pasuritë e fituara si oborr në përdorim, janë kryer transaksione si ndarje pasurie dhe më pas tjetërsimi i një pjesë të pasurisë truall tek persona të tretë, në kundërshtim me VKM nr. 578, datë 29.08.2012 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit në pronësi të oborreve në përdorim”, të ndryshuar, pika 8, germa a) *dokumentin për të drejtën e pronësisë së kërkuesit mbi ndërtimin, që gjendet brenda ose në lidhje funksionale me oborrit në*

përdorim, i lëshuar nga ZVRPP-ja, pasi sipërfaqet e tjetërsuara nuk janë më në lidhje funksionale me ndërtesën duke ndryshuar pronësinë, çka nuk justifikon qëllimin dhe kushtin mbi bazën e të cilit është fituar pronësia mbi “oborrin në përdorim” pra lidhja funksionale e ndërtesës me truallin (Trajtuar më hollësisht në faqe 14-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 40: Nga Regjistruesi i ZVRPP Dibër, të merren masat që në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, të vendoset kufizim mbi pasuritë të cilat nuk janë tjetërsuar përkatësisht nr. 22/286, vol. 29, fq. 246, zk. 2932, nr. 22/288, vol. 29, fq. 248, zk. 2932 dhe nr. 24/85, vol. 27, fq. 197, zk. 2932 deri në korrigjimin e vendimit të AKKP-së në përputhje me aneksin nr. 1, të VKM nr. 578, datë 29.08.2012 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit në pronësi të oborreve në përdorim”, ndryshuar me VKM nr. 790, datë 14.11.2012, ku sipërfaqet e oborreve në përdorim janë përcaktuar sipas nenit 6, të Dekretit nr. 7011, të vitit 1985.

Menjëherë

Rekomandimi 41: ZVRPP Dibër në çdo rast të regjistrimit të vendimeve të AKKP-së për oborret në përdorim duhet të kontrollojë elementët e formës dhe përmbajtjes në përputhje me UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit” dhe VKM nr. 578, datë 29.08.2012 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit në pronësi të oborreve në përdorim”, ndryshuar me VKM nr. 790, datë 14.11.2012.

Në vazhdimësi

Gjetje 26 : Nga auditimi rezultoi se listat e trojeve të përcjella për regjistrim për zonat kadastrale zk. 3023/Pollozhan, zk. 3440 Fshati Shullo, zk. 3142/ Radomire, zk. 3275/Selane, zk. 2653/Menesh, zk. 3399/Shimcan, zk. 2640/Melan, zk. 3639/Trepce, zk. 3898/Zdojan, zk. 3570/Tejs, zk. 3566/Tartaj, zk. 3439/Saricë, zk. 2084/Qan, dhe zk. 3475/ Sllatinë, janë të pa firmosura dhe vulosura nga Kryeplaku dhe Kryetari i Komunës. Regjistrimi i pasurive me dokumentacion jo të rregullt që nuk përmbush të gjithë elementët e formës dhe përmbajtjes të një dokumenti ligjor vjen në kundërshtim me Ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”(Trajtuar më hollësisht në faqe 26-32..të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 42: Nga ZVRPP Dibër të merren masa që në çdo rast për kryerjen e regjistrimeve sipas listave të trojeve të kontrollohet nëse dokumentacioni i përcjellë për regjistrim, përmbush të gjithë elementët e formës dhe përmbajtjes të një dokumenti ligjor në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” si dhe Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

Në vazhdimësi

Gjetje 27: Nga verifikimi i regjistrimeve të kryera sipas listës 001 “Lista emërore e pronave të trojeve dhe të shtëpive”, në zonën kadastrale 3942/Zimur, në 16 raste rezultoi se personat kanë marrë më shumë sipërfaqe se 300 m², në total sipërfaqe tepër 2984 m². Nga këto në 12 raste nuk janë kryer veprime në KPP, ndërsa në 4 raste janë kryer veprime dhe transaksione me pasuritë si lëshim certifikatë pronësie, regjistrim dëshmi trashëgimie, pjesëtim pasurie, pa verifikuar gjendjen e pasurive dhe pa veçuar më parë sipërfaqen tepër prej 606 m² në shtet, trajtuar më hollësisht në pasqyrën nr. 1, emërtuar “Pasuri me sipërfaqe

trojesh mbi normë sipas Listave 001 të Hartuara, për ZK 3942 Zimur Rrethi Dibër” bashkangjitur Raportit për pasuritë si vijon; -Pas. nr. 311, vol. 2, fq. 40, -Pas nr. 314, vol. 2, fq. 171, -Pas nr. 246, vol. 2, fq. 176 - Pas nr. 136, vol 2, fq. 133, -Pas nr. 224, vol. 1, fq. 139, -Pas nr. 230, vol 1, fq. 152, -Pas nr. 234, vol. 1, fq. 13, -Pas nr. 302, vol. 1, fq. 111, -Pas nr. 317, vol. 1, fq. 166, -Pas nr. 318, vol. 1, fq. 108, -Pas nr. 322, vol. 1, fq. 169 dhe -Pas nr. 117/1, vol. 2, fq. 13, **në zonë kadastrale 3566/Tartaj**, në 9 raste rezultoi se personat kanë marrë më shumë sipërfaqe se norma 300 m2, në total sipërfaqe tepër **1131 m2**. Nga këto në 8 raste nuk janë kryer veprime në KPP, ndërsa në 1 rast është kryer veprim dhe transaksione me pasurinë, regjistrim dëshmi trashëgimie, pa verifikuar gjendjen e pasurisë dhe pa veçuar më parë sipërfaqen tepër prej **176 m2** në shtet, trajtuar më hollësisht në pasqyrën nr. 3, emërtuar *“Pasuri me sipërfaqe trojesh mbi normë sipas Listave 001 të Hartuara, për ZK 3566 Tartaj Rrethi Dibër”* bashkangjitur Projekt Raportit, për pasuritë si vijon; -Pas. nr. 24, vol. 2, fq. 59, -Pas nr. 31, vol. 2, fq. 51, -Pas nr. 142, vol. 1, fq. 45 - Pas nr. 250, vol 2, fq. 66, -Pas nr. 252, vol. 2, fq. 95, -Pas nr. 325, vol. 1, fq. 236, -Pas nr. 398, vol. 1, fq. 240, -Pas nr. 470, vol. 1, fq. 80 dhe -Pas nr. 554, vol. 2, fq. 32, **në zonë kadastrale 3026/ Popinare**, në 1 rast personat kanë marrë më shumë sipërfaqe se 300 m2, në total sipërfaqe tepër **50 m2**, në të cilin nuk janë kryer veprime në KPP, trajtuar më hollësisht në pasqyrën nr. 4, emërtuar *Pasuri me sipërfaqe trojesh mbi normë sipas Listave 001 të Hartuara, për ZK 3026 Popinare Rrethi Dibër*” bashkangjitur Raportit, për pasurinë nr. 695/1, vol 1, fq. 113, në kundërshtim me dekretin e Presidentit nr. 5747 datë 29.06.1978, dhe Ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” si dhe Rregulloren nr. 184, datë 08.04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 26-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 43: Nga Regjistruesi i ZVRPP Dibër të merren masa në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, të mos kryen veprime në kartela deri në verifikimin dhe saktësimin në bashkëpunim me Bashkinë Dibër të listave të kryefamiljarëve gjendje në vitin 1991, si dhe në ato raste kur vërtetohet që është përfituar sipërfaqe mbi normën prej 300 m2, të shfuqizohen certifikatat e lëshuara dhe veçimin e regjistrimit shtet të sipërfaqeve tepër në KPP pa veprim trajtuar më hollësisht në pasqyrat nr. 1, emërtuar *“Pasuri me sipërfaqe trojesh mbi normë sipas Listave 001 të Hartuara, për ZK 3942 Zimur Rrethi Dibër”*, pasqyrën nr. 3, emërtuar *“Pasuri me sipërfaqe trojesh mbi normë sipas Listave 001 të Hartuara, për ZK 3566 Tartaj Rrethi Dibër”* dhe pasqyrën nr. 4, emërtuar *“Pasuri me sipërfaqe trojesh mbi normë sipas Listave 001 të Hartuara, për ZK 3026 Popinare Rrethi Dibër”*.

Menjëherë

Gjetje 28: Nga auditimi për regjistrimin e pasurive sipas listave të trojeve 001 në zonën kadastrale 3942/Zimur, rezultoi se janë të paidentifikuara me emër objekti apo ndërtesa 3 pasuri shtet me sipërfaqe totale trullsi **1456 m2** dhe sipërfaqe ndërtimi **186 m2**, trajtuar hollësisht sipas pasqyrës nr. 2, emërtuar *“Pasuri shtet të paidentifikuara”*, bashkangjitur Projekt Raportit, për pasuritë si vijon Pas nr. 214, vol. 2 , fq. 247 , Pas nr. 215, vol 2, fq. 246 dhe Pas nr. 242, vol. 3, fq. 54(*Trajtuar më hollësisht në faqe 28-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 44: Nga ZVRPP Dibër të merren masa për identifikimin e 3 pasurive shtet, si dhe të pasurive të tjera objekte shtetërore të paidentifikuara deri më tani, duke bërë shënimet përkatëse në kartelat e pasurive në përputhje me Ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” dhe Udhëzimin metodik Nr. 76 Prot, datë 13.09.1999 *“Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme”*.

Menjëherë

Gjetje 29: Në 6 raste nga verifikimi i listës 001 “*Lista emërore e pronave të trojeve dhe të shtëpive*”, në zonën kadastrale 3942/Zimur rezultoi se personat kishin marrë më shumë se një pasuri me listë trojesh, sipërfaqen tepër prej **1668 m²**, kjo pa u shoqëruar me dokumentacion tjetër justifikues, në kundërshtim me dekretin e Presidentit nr. 5747 datë 29.06.1978, dhe Ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” si dhe Rregulloren nr. 184, datë 08. 04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, për pasuritë si vijon; -Pas. nr. 311, vol. 2, fq. 40, - Pas nr. 314, vol. 2, fq. 171, -Pas nr. 300, vol 1, fq. 209, -Pas nr. 306, vol. 2, fq. 172, -Pas nr. 289, vol 2, fq. 45, -Pas nr. 323, vol. 2, fq. 46, -Pas nr. 246, vol. 2, fq. 176, -Pas nr. 293, vol. 1, fq. 191, -Pas nr. 218, vol 2, fq. 179, -Pas nr. 37, vol. 2, fq. 4 dhe -Pas nr. 135, vol 2, fq. 181 (*Trajtuar më hollësisht në faqe 26-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 45: Nga Regjistruesi i ZVRPP Dibër të merren masa në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e personave të cilët kanë përfituar më shumë se një pronë nga lista e trojeve, për zonën kadastrale 3942/Zimur, për pasuritë si vijon: -Pas. nr. 311, vol. 2, fq. 40, -Pas nr. 314, vol. 2, fq. 171, -Pas nr. 300, vol 1, fq. 209, -Pas nr. 306, vol. 2, fq. 172, -Pas nr. 289, vol 2, fq. 45, -Pas nr. 323, vol. 2, fq. 46, - Pas nr. 246, vol. 2, fq. 176, -Pas nr. 293, vol. 1, fq. 191, -Pas nr. 218, vol 2, fq. 179, -Pas nr. 37, vol. 2, fq. 4 dhe -Pas nr. 135, vol 2, fq. 181, deri në verifikimin dhe saktësimin në bashkëpunim me Bashkinë Dibër të listave të kryefamiljarëve gjendje në vitin 1991, deri në shfuqizimin certifikatave të lëshuara dhe veçimin e regjistrimin shtet të sipërfaqeve tepër në KPP pa veprim tjetërsimi tek persona të tretë.

Menjëherë

Gjetje 30: Nga auditimi i regjistrimit të pasurive me AMTP ngjyrë jeshile u konstatuan mangësi në dokumentacionin e përcjellë për regjistrim, pasi mungonte certifikata e gjendjes familjare e datës 01.08.1991, kërkesa e bëra nga personat, dokumentacioni për shfuqizimin e AMTP-së së vjetër, gjithashtu në asnjë rast nuk është plotësuar shtojca nr. 5 për verifikimin e elementëve të formës dhe përmbajtjes, veprime këto në kundërshtim me Ligjin 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, VKM Nr. 253, datë 6.3.2013 “Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatrat e ish-kooperativave bujqësore”, pika 17, germa a, pika 26 dhe 27, Udhëzimin nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrin të regjistruesit” pika 5 si dhe Rregulloren nr. 184, datë 08. 04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, Kreu IV, pika 1 (*Trajtuar më hollësisht në faqe 32-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 46: Nga ZVRPP Dibër në çdo rast të regjistrimit të pasurive me AMTP ngjyrë jeshile të verifikohet dokumentacioni i përcjellë për regjistrim nëse është në përputhje me kërkesat e VKM nr. 253, datë 6.3.2013 “Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatrat e ish-kooperativave bujqësore”.

Në vazhdimësi

Gjetje 31: Pjesa dërrmuese e AMTP-ve të vjetra të përcjella për regjistrim janë me mangësi të theksuara, nuk përmbajnë datën kur është lëshuar, nuk ka të përcaktuar pasuritë kufitare, nuk është firmosur dhe vulosur nga Kryetari i Komisionit të Tokës, nga Përfaqësuesi i Rrethit, dhe nuk është firmosur nga vetë përfituesi i titullit të pronësisë. Mangësitë e mësipërme vinë në kundërshtim me Ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", Ligjin 33/2012

“Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, si dhe Rregulloren nr. 184, datë 08. 04.1999, ndryshuar nr.7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme” (*Trajtuar më hollësisht në faqe 32-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 47: ZVRPP Dibër të marrë masa që në çdo rast të paraqitjes për regjistrim të AMTP-ve me mangësi, të refuzojë regjistrimin e tyre deri në saktësimin dhe verifikimin e elementëve të formës dhe përmbajtjes në përputhje me Ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", ligjin 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit” pika 5.

Në vazhdimësi

Gjetje 32: Në 2 raste nga regjistrimi i pasurive me AMTP ngjyrë jeshile rezultoi se personat kanë përfituar me tepër sipërfaqe se norma e lejuar pasi në certifikatat e gjendjes familjare të datës 01.08.1991 janë përfshirë dhe persona të lindur pas kësaj date të cilët nuk trajtohen në bazë të ligjit nr. 7501, date 19.07.1991, “Për Tokën”, duke përfituar padrejtësisht sipërfaqen prej **1242 m²**, përkatësisht për pasuritë nr. 148/9, volum dhe faqe e pa përcaktuar në kartelë, zk. 3023 Pollozhan, regjistruar me Ref. 085, datë 15.0 2.2015, në pronësi të Z., M., R., A dhe O. E., si dhe pasurinë nr. 558/5, vol 5, fq. 2, zk. 2730, veprime këto që bien në kundërshtim me Ligjin 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe VKM Nr. 253, datë 6.3.2013 “Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatrat e ish-kooperativave bujqësore”, pika 12, 17, germa a, pika 26 dhe 27 (*Trajtuar më hollësisht në faqe 32-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 48: Nga Regjistruesi i ZVRPP Dibër të merren masa në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, të nxjerrë urdhër kufizimi mbi pasuritë nr. 148/9, volum dhe faqe e pa përcaktuar në kartelë, zk. 3023 Pollozhan, regjistruar me Ref. 085, datë 15.0 2.2015, në pronësi të Z., M., R., A dhe O. E., si dhe pasurinë nr. 558/5, vol 5, fq. 2, zk. 2730 deri në saktësimin e normës për frymë sipas certifikatës të gjendjes familjare të datës 01.08.1991 dhe veçimin e sipërfaqes tepër në shtet.

Menjëherë

Gjetje 33: Në 4 raste janë shfaqur mangësi në regjistrim e pasurive me AMTP pasi për **Ref. 073, datë 15.0 2.2015**, pasuria nr. 148/3, vol. 3, fq. 66, zk. 3023 certifikata familjare me nr. 003894608, që tregon trungun familjar në datë 01.08.1991 e përbërë prej 8 personash, ndërkohë që AMTP është lëshuar vetëm në emër të S. E., duke përfituar në total sipërfaqen prej 4400 m², për **Ref. 083, datë 15.0 2.2015**, pasuria nr. 148/7, vol. 3, fq. 70, zk. 3023 mungon certifikata familjare gjendje 01.08.1991, për **ref. 077, datë 29.04.2015**, pasuria nr. 819/19, vol 5, fq. 25, zk. 2730, certifikata familjare e administruar në dosje nuk tregon gjendjen familjare në datë 01.08.1991, por mban shënimin “*Trungun familjar i vitit 1991*”, e cila përbehet prej 6 pjesëtarësh, pa ju referuar datës 01.08.1991, për **Ref. 077, datë 26.12.2014**, pasuria nr. 98/11, vol 3, fq. 7, zk. 3023, AMTP është lëshuar vetëm në emër të A. Z. dhe regjistrimi në KPP është bërë vetëm në emër të A. Z., si përfitues i vetëm, pa patur një bilanc të pasurive të trungut familjar gjendje 01.08.1991. Mangësitë e mësipërme vinë në kundërshtim me ligjin nr. 7501, date 19.07.1991, “Për Tokën”, ligjin nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, dhe VKM Nr. 253, datë 6.3.2013 “Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatrat e ish-kooperativave bujqësore” (*Trajtuar më hollësisht në faqe 32-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 49: Nga Regjistruesi i ZVRPP Dibër të merren masa në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, të nxjerrë urdhër kufizimi mbi pasuritë nr. 148/3, vol. 3, fq. 66, zk. 3023, nr. 148/7, vol. 3, fq.70, zk. 3023, nr. 819/19, vol 5, fq. 25, zk. 2730 dhe nr. 98/11, vol 3, fq.7, zk. 3023 deri në plotësimin e dokumentacionit dhe saktësimin të normës për frymë sipas certifikatave të gjendjes familjare të datës 01.08.1991.

Menjëherë

Gjetje 34: Një pjesë e madhe e kartelave të pasurive të paluajtshme nuk janë firmosur e vulosur nga Regjistruesi, gjithashtu në një pjesë të tyre janë kryer transaksione me pasuritë pa përcaktuar referencën me anë të cilës është kryer veprimi si dhe nuk është përcaktuar se ku kalon pasuria, nuk janë firmosur në seksionin përkatës nga specialisti që ka punuar praktikën, veprime të gjitha këto që bien në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit metodik nr. 76 prot, datë 13.09.1999 “Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme”, si dhe Rregulloren nr. 184, datë 08. 04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme” (*Trajtuar më hollësisht në faqe 32-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 50: ZVRPP Dibër të marrë masa që në çdo rast të plotësimin të kartelave të pasurive të zbatohen kërkesat e Udhëzimit metodik Nr. 76 prot, datë 13.09.1999 “Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme”, si dhe Rregulloren nr. 184, datë 08. 04.1999, ndryshuar nr.7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të shënohet referenca me anë të cilës do të kryen veprimet mbi pasurinë, të firmosen e vulosen nga Regjistruesi si dhe nga specialisti që ka punuar praktikën në seksionin përkatës.

Në vazhdimësi

Gjetje 35: ZVRPP Dibër për vitin 2015 ka pranuar e regjistruar **49 leje ndërtimi objektesh** mbi truall shtetëror e privat, me mangësi në formë e përmbajtje të dokumentacionin përbërës, prej të cilave në **38 leje** sheshi ndërtimi të lëshuara nga Bashkia në vitet 2004-2013 mbi truall publik në sipërfaqen **2024 m²**, dërguar për regjistrim të objekteve në periudhën Janar 2015-Dhjetor 2015 paraqitur në tabelën emërtuar “*Regjistrimi i Lejeve të Ndërtimit lëshuar në troje publike nga Bashkia pa Marrëdhënien e Truallit dhe Efekti i vlerës së Truallit dhe Vlera e Qirasë së Akumuluar Viti 2015*”, duke mos refuzuar e kthyer dokumentacionin e mangët, mos kërkuar ndaj Bashkisë Dibër zgjidhjen e marrëdhënies së truallit me pasojë detyrimet e rrjedhura në vlerën **6,905,888 lekë** vlerë trualli (llogaritur sipas VKM dhe vlera prej **17,546,320** nivel qiraje nga përdorimi dhe zënia me ndërtim pa titull pronësie, për të cilat ZVRPP Dibër nuk ka vendosur as barrë mbi pronë mbi pasuritë ndërtimore të paktën në vlerën përkatëse të qirasë së përdorimit, dukë shkaktuar dëmin ekonomik të mësipërm për buxhetin e Bashkisë; në kundërshtim me nenet 30, 32 të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për Urbanistikën”, i ndryshuar, me nenin 13 të ligjit nr 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, në kundërshtim me UKM nr. 3, datë 15.2.2001 i ndryshuar “Për Kontrollin dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”, me ndryshime, në kundërshtim me kreun IV pikat 12.1-7 të Rregullores nr. 184, datë 18.4.1999 “Për Punën në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, në kundërshtim me nenin 46, pikat 1-5 të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, dhe në pikën 4 ku shprehet: “...Regjistruesi informon brenda 10 ditëve organet e administratës tatimore për regjistrimin e lejes së ndërtimit...” dhe në bazë të ligjit 33/2012 nenit 23 ku shprehet: “...Regjistruesi dhe çdo punonjës tjetër i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme mbajnë përgjegjësi ligjore për veprimet dhe aktet e lëshuara prej tyre...” (*Trajtuar në faqet 93-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 51: ZVRPP Dibër, Regjistruesi të nxjerrë urdhër të veçantë të vendosë barrë mbi pronën në seksionin “D” të KPP-ve ZK. 2932 Qytet dhe në Regjistrat Hipotekore në vlerën **6,905,888 lekë** vlerë trualli (llogaritur sipas VKM) dhe vlera prej **17,546,320 lekë** nivel qeraje nga përdorimi dhe zënia me ndërtim pa titull pronësie, mbi pasuritë e llojit ndërtesa nga **38 leje** sheshi ndërtimi të lëshuara nga Bashkia në vitet 1997-2011 mbi truall publik në sipërfaqen **2024 m²**, dërguar për regjistrim të objekteve në periudhën për periudhën Janar 2015-Dhjetor 2015, të regjistruara pa marrëdhënie trualli dhe me dokumentacion të parregullt deri në likuidimin e detyrimeve ndaj Bashkisë Peshkopi dhe zgjidhjen ligjore të pronësisë mbi truallin ; si dhe të njoftojë e ti kërkojë Bashkisë Peshkopi zbatimin e procedurave ligjore dhe kontratore rrjedhur nga lejet e shesheve, dhënia e lejeve të përdorimit të ndërtesave deri në heqjen e barrëve mbi këto pasuri, paraqitur në tabelën emërtuar “Regjistrimi i Lejeve të Ndërtimit lëshuar në troje publike nga Bashkia pa Marrëdhënien e Truallit dhe Efekti i vlerës së Truallit dhe Vlera e Qirasë së Akumuluar Viti 2014”.

Brenda 15 Dhjetor 2016

Gjetje 36: Në 6 raste janë shfaqur mangësi në dokumentacionin e përdorur për regjistrimin e pasurive me leje legalizimi për pasuritë nr. 30/114, vol. 29, faqe 185, zk, 2932, nr. 14/32/1, vol. 29, faqe 127, zk, 2932, nr. 35/272, vol. 29, faqe 29, zk, 2932, nr. 35/276, vol. 29, faqe 173, zk, 2932, nr. 23/101, vol. 29, faqe 28, zk, 2932, nr. 17/14, vol. 29, fq. 118, zk. 2932 pasi mungon ortofoto dixhitale dhe HTR e përditësuar për të gjithë zonën informale, ka mospërputhje të sipërfaqeve ndërmjet planimetrisë dhe lejes së legalizimit, mos rregullim të marrëdhënieve me truallin, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 258, datë 04.05.2007 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, të legalizuara” pika 11.1 -Dorëzimi i dokumentacionit përkatës të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të legalizuara, në ZVRPP dhe Udhëzimin nr. 2532, datë 21.04.2009, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të fituara sipas ligjit nr. 9482, date 03.04.2006; ”Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale” (Trajtuar më hollësisht në faqe 148-155 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 52: Nga Regjistruesi i ZVRPP Dibër, të merren masat për nxjerrjen e urdhrimit të kufizimit në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor mbi pasuritë si vijon: - nr. 30/114, vol. 29, faqe 185, zk, 2932, - nr. 14/32/1, vol. 29, faqe 127, zk, 2932, - nr. 35/272, vol. 29, faqe 29, zk, 2932, - nr. 35/276, vol. 29, faqe 173, zk, 2932, - nr. 23/101, vol. 29, faqe 28, zk, 2932, - nr. 17/14, vol. 29, fq. 118, zk. 2932.

Menjëherë

Gjetje 37: Nga ana e ZVRPP Dibër janë pranuar për regjistrim Vendime të Gjykatave me objekt njohjen pronar për pasuritë përkatëse, çka kërkon interpretim të germës “dh” dhe të paragrafit të fundit të nenit 193 të Kodit Civil, në lidhje me formën dhe përmbajtjen si dhe ngjashmërinë me vendimet gjyqësore të njohjes së faktit, pa verifikuar më parë elementët e formës dhe përmbajtjes në kundërshtim me Ligjin nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, nenit 45, pika 2 dhe 3 si dhe me Udhëzimin nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrimit të regjistruesit”, pika 3, shtojca nr. 1 (Trajtuar më hollësisht në faqe 155-157 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Rekomandimi 53: Nga ana e ZVRPP Dibër të merren masat që në çdo rast të regjistrimit të vendimeve me objekt njohje pronar të verifikohen elementët e formës dhe përmbajtjes në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të

paluajtshme”,nenit 45, pika 2 dhe 3 si dhe me Udhëzimin nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit”, pika 3, shtojca nr. 1.

Në vazhdimësi

A. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, pjesa e VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative dhe (Nëpunësi zbatues), të kryejë kontabilizimet duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore, administrative dhe procedurat përmbareme me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në vlerën totale **110,086 mijë lekë**, si më poshtë:

Rekomandim 1: ZVRPP Dibër, Regjistruesi të njoftojë e ti kërkojë Bashkisë Dibër zbatimin e procedurave ligjore dhe kontratore,(sa rekomanduar masa org. nr. 11, më sipër) dhe të ndiqen hapat e duhur ligjor nga të dy këto institucione për arkëtimin e dëmit ekonomik në **vlerën 26,189 mijë lekë** ndarë: **6 636 538 lekë** vlerë truall (llogaritur sipas VKM) dhe vlera prej **19 552 800 lekë** nivel qiraje nga përdorimi dhe zënia me ndërtim pa titull pronësie, mbi pasuritë e llojit ndërtesa për **26 leje** sheshi ndërtimi të lëshuara nga Bashkia në vitet 1997-2011 mbi truall publik në sipërfaqen **1945 m²**, dërguar për regjistrim te objekteve në periudhën tetor 2013-nëntor 2014, të regjistruara pa marrëdhënie truall dhe me dokumentacion të parregullt; krahas sa rekomanduar për të nxjerrë urdhër të veçantë dhe vendosë barrë mbi pronën në seksionin “D” të KPP-ve ZK. 2932 Qytet dhe në Regjistrat Hipotekore deri në likuidimin e detyrimeve ndaj Bashkisë Peshkopi dhe zgjidhjen ligjore të pronësisë mbi truallin rrjedhur nga lejet e shesheve dhe nga dhënia e lejeve të përdorimit të ndërtesave, paraqitur në tabelën emërtuar “Regjistrimi i Lejeve të Ndërtimit lëshuar në troje publike nga Bashkia pa Marrëdhënien e Truallit dhe Efekti i vlerës së Truallit dhe Vlera e Qirasë së Akumuluar Viti 2014”.

Brenda 15 Dhjetor 2016

Rekomandim 2: ZVRPP Dibër, Regjistruesi, të njoftojë Bashkinë Dibër dhe qytetarin M.R.M (përveç sa rekomanduar masa org. nr.28, më sipër) dhe të ndiqen hapat e duhur ligjor për arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën **prej 9,665,000 lekë** që përbën vlerën nga qera e pa llogaritur e pa arkëtuar për Bashkinë Peshkopi nga përdorimi pa titull pronësie i sipërfaqes prej 430 m² truall (370 m² truall dhe 60 m² truall i ndërtesës) nga qytetari M.R.M , sipas lejes së ndërtimit nr.494 Prot, VKRT Këshillit Rrethit nr. 4, datë 15.10.1992 sipas Gen planit bashkëlidhur Ref. 004906 sipërfaqe e Sheshit prej 370 m² ku ndodhet dhe godina 60 m² që përdoret si pikë tregtimi karburanti që rrjedh nga Pasuria regjistruar në regjistrin hipotekor nr.160, datë 01.10.2010 truall 612 m², kaluar ne regjistrin hipotekor nr.165, datë 05.10.2010, në pronësi të Qytetarit M.R.M si dhe regjistruar në KPP pasuria nr. 9/131, v.20, f.75, z k. 2392 Qytet Peshkopi me sipërfaqe 612 m² truall, lëshuar certifikatë ne pronësi të Qytetarit M.R.M, rrjedhur nga **kontrata e këmbimit** nr. 9995 Rep. nr. 1212/2 kol. datë 04.10.2010, ndërmjet Bashkisë dhe Qytetarit M.R.M, si dhe nga mos regjistrimi në pronësi të Bashkisë ndërsa është regjistruar në KPP pasuria nr.9/77 (korrigjuar 9/4/1) v.3,f.125 zk. 2932 truall me sipërfaqe 463 m² truall, mbetur ne pronësi të Qytetarit pas transaksionit të mësipërm..

Brenda 15 Dhjetor 2016

Rekomandim 3 : ZVRPP Dibër, Regjistruesi të analizojë nxjerrë përgjegjësinë e zhdëmtojë vlerën prej **300,000 lekë** të kamatë vonesës të pa llogaritur dhe të pa arkëtuar (rekomanduar masa org. nr.29, më sipër), në regjistrimin e vonuar të pasurive ndërtesa e troje të Postës Shqiptare sh.a, Dega Peshkopi, zk 2932 regjistruar në hipotekë dhe lëshimin e vërtetimeve hipotekore nr. 69 dhe nr.70, datë 04.04.2013, krahas marrjes masës për nxjerrjen e urdhër kufizimit, në bazë të ligjit nr.33/2012, datë 29.4.2012”Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 5 pika 1, neni 59, 60, 74 deri në likuidimin e vlerës së kamatë vonesës .

Brenda 15 Dhjetor 2016

Rekomandim 4: ZVRPP Dibër, Regjistruesi të njoftojë e ti kërkojë Bashkisë Dibër zbatimin e procedurave ligjore dhe kontratore, (sa rekomanduar masa organizative 33 sa më sipër) dhe të ndiqen hapat e duhur ligjor nga të dy këto institucione për arkëtimin e dëmit ekonomik në **vlerën 47.303 mijë lekë** ndarë: **18,299,233 lekë** vlerë trualli (llogaritur sipas VKM) dhe vlera prej **29,003,930 lekë** nivel qiraje nga përdorimi dhe zënia me ndërtim pa titull pronësie, mbi pasuritë e llojit ndërtesa për **65 leje** sheshi ndërtimi të lëshuara nga Bashkia në vitet 1997-2013 mbi truall publik në sipërfaqen **4970 m²**, dërguar për regjistrim te objekteve në periudhën janar tetor 2013, të regjistruara pa marrëdhënie trualli dhe me dokumentacion të parregullt; krahas sa rekomanduar për të nxjerrë urdhër të veçantë dhe vendosë barrë mbi pronën në seksionin “D” të KPP-ve ZK.2932 Qytet dhe në Regjistrat Hipotekore deri në likuidimin e detyrimeve ndaj Bashkisë Peshkopi dhe zgjidhjen ligjore të pronësisë mbi truallin rrjedhur nga lejet e shesheve dhe nga dhënia e lejeve të përdorimit të ndërtesave, paraqitur në tabelën emërtuar “Regjistrimi i Lejeve të Ndërtimit lëshuar në troje publike nga Bashkia pa Marrëdhënien e Truallit dhe Efekti i vlerës së Truallit dhe Vlera e Qirasë së Akumuluar Viti 2013”.

Brenda 15 Dhjetor 2016

Gjetje: ZVRPP Dibër për **7 raste**, të marrë masat për arkëtimin e **vlerës prej 763,362 lekë që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit**, e përbërë nga:

-Vlera **prej 9,000 lekë** për mos prerje aplikim për shërbimin e HTR-së për 9 pasuri x 1000 lekë, në ZK nr. 1371, fshati Çeren për 9 AMTP me nr. 2, datë 26.12.2013, për pasuritë nr. 210, volum 1, faqe 210; nr. 170, volum 1, faqe 120; nr. 151, volum 1, faqe 151; nr. 804/1, volum 5, faqe 167; nr. 145, volum 1, faqe 145; nr. 560/1, volum 5, faqe 169; nr. 171, volum 1, faqe 171; nr. 854, volum 4, faqe 104 dhe nr. 558, volum 5, faqe 171;

-Vlera **prej 111,000 lekë** për diferencë tarife në të dyja rastet nga 6,500 lekë në 5,000 lekë, sipas listës së shërbimeve “Regjistrim Përfundimtar i ndërtimeve të reja” në zbatim të urdhrit e përbashkët nr.5341/5, datë 07.09.2012 të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave “Për miratimin e tarifave të shërbimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, për pasuritë nr. 14/225 ND, volum 26, faqe 160 dhe nr. 14/230, v 26, faqe 47.

-Vlera **prej 113,172 lekë** për mos llogaritje e ndalur taksa e kalimit të pronësisë ndaj Investitorit Astrit Ademi, për sipërfaqen totale të përbashkët prej 80 m² në vlerën prej **24,000 lekë** (80m²x300 lekë/m²/ndërtim) dhe subjekti “A&G” shpk, për sipërfaqen totale të përbashkët prej 297.24 m² në vlerën prej **89,172 lekë** (297.24 m² x 300 lekë/m²/ndërtim) (sipas planimetrive të objektit, pjesë e dosjes), për pasuritë nr.14/225 ND, volum 26, faqe 160 dhe pasuria nr. 14/230, volum 26, faqe 47.

- Vlera **prej 24,000 lekë** për mungesë aplikimi në praktikën me referencë 011895, në ZK nr. 2932 qyteti Peshkopi, për shërbimin e regjistrimit fillestar për çdo pasuri dhe konkretisht pasuria nr. 22/278-ND1, plotësuar vërtetim hipotekor nr. 486, datë 06.12.2013, pas nr.

22/279-ND, plotësuar 487, datë 06.12.2013, pas nr. 22/280-ND1, plotësuar nr. 488, datë 06.12.2013 dhe pas nr. 22/281-ND1, plotësuar vërtetim hipotekor nr. 489, datë 06.12.2013;

-Vlera **prej 300,000 lekë** për mos regjistrim të vendimeve të gjykatave nr. 193, datë 15.07.2002 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendim nr. 399, datë 27.03.2003 dhe Gjykata e Lartë Tiranë me vendim nr. 466, datë 01.03.2004(10% e tarifës prej 3500 lekë që duhet të paguante nga data 01.04.2004, pra 2268 ditë vonesa në regjistrim = 793,000, por në bazë të nenit 39 të ligjit nr. 33/1012 jo më shumë se 300,000 lekë)

-Vlera **prej 123,480 lekë** për mos regjistrim të dëshmi trashëgimive sipas vendimit nr. 122, datë 30.03.2006, që duhet të paguante kamat vonesën, për pasurinë nr. 22/68.

- Vlera **prej 1710 lekë** vonesa në regjistrim të kontratë dhurimi e të drejtës së parablerjes, nr. 512 rep dhe nr. 187/1 kol, datë 06.03.2013, pra 19 ditë kamat vonesa, veprime në kundërshtim me urdhrin e përbashkët nr. 5341/5, datë 07.09.2012 të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave “Për miratimin e tarifave të shërbimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme”(Trajtuar më hollësisht në faqet 26-44, 44-59,114-119 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 5: Regjistruesi i ZVRPP Dibër, të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i shumës **763,362 lekë** për pasuritë trajtuar rast pas rasti.

Brenda muajit Dhjetor 2016

Gjetje: Nga ZVRPP Dibër nuk është llogaritur e ndalur kamat vonesa për regjistrimin e vonuar të Vendimit të AKPP-së nr. 53 prot, datë 22.12.1995 për pasurinë 15/38, vol 26, fq. 136, zk. 2932, pasi ka kaluar një periudhë prej 3 vitesh nga koha që është fituar titulli i pronësisë sipas Vendimit të AKPP-së dhe procesverbalit të marrjes në dorëzim të pronës deri në momentin kur është marrë Vendimi i Gjykatës nr. 191, datë 21.05.2013, dhe lëshuar certifikata e vdekjes datë 21.10.2010. Mos aplikimi i kamat vonesës vjen në kundërshtim me ligjin nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, neni 39-Vonesa e paraqitjes së dokumentacionit për regjistrim, duke i shkaktuar buxhetit shtetit një dëm ekonomik dhe të ardhura të munguara **në vlerë 300,000 lekë** (Trajtuar më hollësisht në faqe 10-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 6: Nga Regjistruesi i ZVRPP Dibër, të merren masat të analizojë nxjerrë përgjegjësinë e zhdëmtojë vlerën prej **300,000 lekë** të kamatë vonesës të pa llogaritur dhe të pa arkëtuar (rekomanduar masa org. më sipër), mbi pasurinë 15/38, vol 26, fq. 136, zk. 2932 deri në likuidimin e vlerës, krahas sa rekomanduar kufizimi

Brenda 15 Dhjetor 2016

Gjetje: Nga ana e ZVRPP Dibër nuk është aplikuar kamat vonesa për regjistrimin e vonuar të pasurisë nr. 148/3, vol. 3, fq. 66, zk. 3023 me AMTP nr. 07, datë 26.12.2013, dhe për të shmangur kamat vonesën është përdorur shkresa e komunës nr. 257 prot, datë 11.07.2014 për regjistrim, ndërkohë që afatet e regjistrimit duhet të llogariteshin sipas shkresës kryesore 397/1, datë 30.12.2013 ku janë përcjellë për regjistrim në total 9 AMTP për fshatin Pollozhan Komuna Tomin, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, neni 39- Vonesa e paraqitjes së dokumentacionit për regjistrim, duke shkaktuar një dëm ekonomik në vlerë **56,350 lekë** (Trajtuar më hollësisht në faqe 26-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 7: Nga Regjistruesi i ZVRPP Dibër të merren masa për zhdëmtimin e vlerës **56,350 lekë regjistrim i vonuar krahas masës së kufizimit** për pasurinë nr. 148/3, vol. 3, fq. 66, zk. 3023 (në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë

29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, të nxjerrë urdhër kufizimi deri në likuidimin e vlerës së konstatuar.

Brenda 15 Dhjetor 2016

Rekomandim 8: ZVRPP Dibër, Regjistruesi të njoftojë e t'i kërkojë Bashkisë Dibër zbatimin e procedurave ligjore dhe kontratore (sa rekomanduar masa organizative 51 sa sipër) si dhe të ndiqen hapat e duhur ligjor nga të dy këto institucione për arkëtimin e dëmit ekonomik në **vlerën 24,452 mijë lekë** ndarë: **6,905,888 lekë** vlerë trualli (llogaritur sipas VKM) dhe vlera prej **17,546,320 lekë** nivel qiraje nga përdorimi dhe zënia me ndërtim pa titull pronësie, mbi pasuritë e llojit ndërtesa nga **38 leje** sheshi ndërtimi të lëshuara nga Bashkia në vitet 2004-2013 mbi truall publik në sipërfaqen **2024 m²**, dërguar për regjistrim të objekteve në periudhën Janar 2015-Dhjetor 2015, të regjistruara pa marrëdhënie trualli dhe me dokumentacion të parregullt; krahas sa rekomanduar për të nxjerrë urdhër të veçantë dhe vendosë barrë mbi pronën në seksionin “D” të KPP-ve ZK. 2932 Qytet dhe në Regjistrat Hipotekore deri në likuidimin e detyrimeve ndaj Bashkisë Peshkopi dhe zgjidhjen ligjore të pronësisë mbi truallin rrjedhur nga lejet e shesheve dhe nga dhënia e lejeve të përdorimit të ndërtesave, paraqitur në tabelën emërtuar “*Regjistrimi i Lejeve të Ndërtimit lëshuar në troje publike nga Bashkia pa Marrëdhënien e Truallit dhe Efekti i vlerës së Truallit dhe Vlera e Qirasë së Akumuluar Viti 2015*”.

Brenda 15 Dhjetor 2016

Gjetje: Në 3 raste nuk është llogaritur e ndalur kamat vonesa për regjistrimin e vonuar të lejes së përdorimit, për pasuritë nr. 13/201-N1, vol. 29, fq. 10, zk. 2932 Dibër, nr. 13/200-N1, vol. 29, fq. 8, zk. 2932 Dibër dhe nr. 1/196-ND, vol. 29, fq. 21, zk. 2932 Dibër dhe për këtë arsye janë përdorur shkresat e Bashkisë Dibër për të përcjellë dokumentacionin për regjistrim, ndërkohë që afati i fundit për përcjelljen e dokumentacionit për regjistrim, ka qenë brenda 30 ditëve, nga data e realizimit të aktit, datë në të cilën ka filluar të shfrytëzohet objekti nga investitori. Mos aplikimi i kamat vonesës vjen në kundërshtim me ligjin nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, neni 39- Vonesa e paraqitjes së dokumentacionit për regjistrim duke i shkaktuar buxhetit shtetit një dëm ekonomik dhe të ardhura të munguara **në vlerë 900,000 lekë** (*Trajtuar më hollësisht në faqe 93-109 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 9 Nga Regjistruesi i ZVRPP Dibër, të merren masat për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **900,000 lekë** e ardhur nga mos llogaritja e kamat vonesës për regjistrimin e vonuar të lejeve të përdorimit si dhe nxjerrjen e urdhrit të kufizimit në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, mbi pasuritë nr. 13/201-N1, vol. 29, fq. 10, zk. 2932 Dibër, nr. 13/200-N1, vol. 29, fq. 8, zk. 2932 Dibër dhe nr. 1/196-ND, vol. 29, fq. 21, zk. 2932 Dibër deri në likuidimin e vlerës.

Brenda 15 Dhjetor 2016

Gjetje: Në dy raste për regjistrimin e pasurive sipas lejeve të ndërtimit nuk është paguar tarifa për regjistrimin përfundimtar të ndërtimeve të reja në vlerën **39,000 lekë** përkatësisht për shtetasin *P.B.* referuar aplikimit nr. 1719, datë 25.05.2015 pagesa e tarifës për regjistrimin përfundimtar të ndërtimeve të reja është bërë vetëm për 4 pasuritë e hedhura në sistem, ndërkohë për 3 pasuritë nr. 12/207+1-4, vol 29, fq. 128, zk. 2932, nr. 12/207+1-5, vol 29, fq. 129, zk. 2932, dhe nr. 12/206+1-4, vol 29, fq. 130, zk. 2932, që nuk janë në sistem për të cilat është lëshuar vërtetim pronësie nuk është paguar tarifa prej 6500 lekë për secilën si dhe për shtetasin *F.Z.*, sipas aplikimit nr. 1310, datë 01.04.2015 pagesa e tarifës për regjistrimin përfundimtar të ndërtimeve të reja është bërë vetëm për regjistrimin e objektit në tërësi sipas lejes së ndërtimit, ndërkohë për 3 pasuritë nr. 11/175-N1, vo. 29, fq. 92, nr.

11/175-N2, vo. 29, fq. 93, nr. 11/175-N3, vo. 29, fq. 94, zk. 2932, që janë sipërfaqe shtesë dhe që nuk janë në sistem për të cilat është lëshuar vërtetim pronësie dhe janë hapur kartela pasurie nuk është paguar tarifa prej 6500 lekë për secilën, veprime këto në kundërshtim me Ligjin 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” dhe Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave nr. 5341/5, datë 07.09.2012 “Për miratimin e tarifave të shërbimit të ofruara nga Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”(Trajtuar më hollësisht në faqe 93-109 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 10: Nga Regjistruesi i ZVRPP Dibër, të merren masat për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **39,000 lekë** e ardhur nga mos pagesa e tarifës për regjistrimin përfundimtar të ndërtimeve të reja si dhe nxjerrjen e urdhrin të kufizimit në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, mbi pasuritë nr. 12/207+1-4, vol 29, fq. 128, zk. 2932, nr. 12/207+1-5, vol 29, fq. 129, zk. 2932, nr. 12/206+1-4, vol 29, fq. 130, zk. 2932, nr. 11/175-N1, vo. 29, fq. 92, nr. 11/175-N2, vo. 29, fq. 93, nr. 11/175-N3, vo. 29, fq. 94, zk. 2932, deri në likuidimin e vlerës.

Brenda 15 Dhjetor 2016

Gjetje: Nga kontrolli i regjistrimeve të kryera sipas lejes së ndërtimit nr. 27, datë 06.04.2011 të KRRT Dibër të dhënë për shtetasin H.H., ka rezultuar se janë regjistruar 19 njësi të reja, shtesa për të cilat në momentin e veçimit dhe hapjes së kartelave si njësi më vete duhet të aplikohet tarifa R11-Për regjistrimin përfundimtar të ndërtimeve të reja, e detyrimisht duhet të paguhej shuma prej 6500 lekë për çdo njësi dhe jo tarifa R9-Regjistrimi i lejes së ndërtimit.

Si rezultat i aplikimit të gabuar të tarifës së regjistrimit buxhetit të shtetit i është shkaktuar një dëm ekonomik në vlerë 104,000 lekë (5500 (6500-1000)*19), në kundërshtim me Ligjin 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme”, dhe Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave nr. 5341/5, datë 07.09.2012 “Për miratimin e tarifave të shërbimit të ofruara nga Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme” (Trajtuar më hollësisht në faqe 93-109 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 11: Nga Regjistruesi i ZVRPP Dibër, të merren masat për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **104,000 lekë** e ardhur nga mos pagesa e tarifës për regjistrimin përfundimtar të ndërtimeve të reja si dhe nxjerrjen e urdhrin të kufizimit në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, mbi pasuritë të krijuara si njësi të reja nga shtesat e pallatit të cilat vijnë nga pasuritë mëmë 13/139/2+1-1, vol 26, fq. 140, zk. 2932, e mbyllur duke vijuar në pasuritë vol. 29, nga fq. 40 deri në fq. 58, sipas nr. të pasurive nga 13/139/2+1-8 deri tek 13/139/2+1-26; - pasuria mëmë 13/139/2-ND, vol 25, fq. 151, zk. 2932, e mbyllur duke vijuar në pasuritë vol. 29, nga fq. 34 deri në fq. 39, sipas nr. të pasurive nga 13/139/2+1-2 deri tek 13/139/2+1-7 dhe pasuria mëmë 13/51+1-5, vol 24, fq. 214, zk. 2932, e mbyllur duke vijuar në pasuritë vol. 28, nga fq. 5 deri në fq. 11, sipas nr. të pasurive nga 13/51+1-6 deri tek 13/51+1-12.

Brenda 15 Dhjetor 2016

Gjetje: Nuk janë llogaritur e ndalur taksa e kalimit të pronësisë ndaj firmës Investitorit H.S. H., për sipërfaqen totale të përbashkët prej 54.7 m² në vlerën prej **16,410 lekë**, që përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit pasi është mosveprim në kundërshtim me ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme neni 50 “Regjistrimi i mjediseve të përbashkëta në ndërtesa”, pika 2 dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.1996 “Për Sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 28, mosveprime që nuk i janë ndalur investitorit qysh në regjistrim, pasi në rastin kur apartamentet dhe njësitë i shiten qytetarëve përfshijnë në çmim dhe vlerën e këtyre ambienteve të përbashkëta (Trajtuar më hollësisht në faqe 93-109 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 12: Nga Regjistruesi i ZVRPP Dibër, të merren masat për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **16,410 lekë** ndaj firmës Investitorit H.S.H, e ardhur nga mos pagesa e taksës për kalimin e pronësisë për sipërfaqet e përbashkëta në kundërshtim me ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme neni 50, “*Regjistrimi i mjediseve të përbashkëta në ndërtesa*”, pika 2 dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.1996 “Për Sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 28.

Brenda 15 Dhjetor 2016

Gjetje: Nga verifikimi i listës së pronave shtetërore të transferuara në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Peshkopi sipas VKM nr. 1533, datë 19.11.2008 “*Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Peshkopi të Qarkut Dibër*”, rezultoi se sipërfaqja e truallit prej 200.6 m², e cila i është nënshtruar procesit të privatizimit sipas kontratës shitjes Nr. 5030 Rep, Nr. 1065 Kol, datë 26.08.2013, për **vlerën 603,084 lekë**, duke kaluar nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike Tiranë në pronësi të subjektit privat H.S.H e regjistruar nga ana e ZVRPP Dibër, është në pronësi të Bashkisë Peshkopi, e për pasojë vlera shitjes prej **603,084 lekë** duhet të transferohet në pronësi të Bashkisë Peshkopi si njësi buxhetore më vete, veprime këto që bien në kundërshtim me Ligjin 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” dhe Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM nr. 1533, datë 19.11.2008 (*Trajtuar më hollësisht në faqe 93-109 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 13: Nga ZVRRP Dibër të merren masa për të njoftuar Bashkinë Peshkopi dhe DASHP për transferimin e vlerës së arkëtuar prej **603,084 lekë** nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike Tiranë tek njësia buxhetore Bashkia Peshkopi në përputhje me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM nr. 1533, datë 19.11.2008 “*Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Peshkopi të Qarkut Dibër*”.

Brenda Dhjetor 2016

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në Kreu IV, germa “c” dhe “ç” dhe neni 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996 dhe ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003, dhe në ligjin nr. 33/2012, datë 29.4.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, si dhe në kontratën individuale të punës, **ti kërkohet Kryeregjistruesit ZQRPP Tiranë**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore nga “**Vërejtje**” deri në “**Largim nga puna**” dhe për ata me kontratë, nga masa “**Vërejtje**” deri në “**Ndërprerje të marrëdhënieve të punës**”, për këta punonjës:

A. Masa “**Vërejtje**”

1. **Për znj. Gj.H.**, me detyrë specialiste sektori shërbimeve mbështetëse, për shkeljet trajtuar në **aktverifikimin nr. 1, procesverbalit nr. 21 dhe trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit.**

2. **Për znj. A.B.**, me detyrë Përgjegjëse Financës , për shkeljet trajtuar në **aktverifikimin nr. 1, procesverbali nr. 3 dhe trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit.**

B. Masa “Vërejtje” deri në “Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”.

1. Për znj. I.S., me detyrë ish specialiste juriste, aktualisht prej v.2013 përgjegjëse sektorit të hartografisë dhe Regjistrimit, për shkeljet trajtuar në **akt verifikimin nr. 1, p procesverbalet nr. 2, nr. 3, nr. 4, nr. 5, nr. 6, nr. 7, nr. 8, nr. 10, nr. 11, nr. 12, nr. 14, nr. 15, nr. 17, nr. 18, nr. 20, nr. 21, nr. 22, nr. 23 dhe trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit.**

2. Për znj. F.P.(Mazari), me detyrë specialiste hartograf prej v.2007 sektori Regjistrimi Fillestar dhe Hartografisë, për shkeljet trajtuar në **procesverbalet nr. 1, nr. 2, nr. 3, nr. 4, nr. 5, nr. 6, nr. 7, nr. 8, nr. 10, nr. 11, nr. 12, nr. 13, nr. 14, nr. 15, nr. 17, nr. 18, nr. 19, nr. 20, nr. 21, nr. 22, dhe nr. 23 dhe trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit.**

3. Për z. E.Sh., me detyrë specialist jurist dhe në cilësinë e pritësit për shkeljet trajtuar në, **procesverbalet nr. 1, nr. 3, nr. 5, nr. 7, nr. 8, nr. 10, nr. 11, nr. 12, nr. 14, nr. 15, nr. 17, nr. 18, nr. 19, nr. 23 dhe trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit.**

4. Për z. F.M., me detyrë Regjistruer prej datës 03.12.2013 e vazhdim për shkeljet trajtuar në **aktverifikimin nr. 1, procesverbalet nr. 2, nr. 3, nr. 4, nr. 12, nr. 13, nr. 15, nr. 17, nr. 18, nr. 20, nr. 21, nr.22, dhe trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit.**

PËR PUNONJËSIT E LARGUAR DHE QË NUK KANË ADRESIM INSTITUCIONAL.

I. Për ish drejtuesit dhe ish punonjësit nuk rekomandojmë masa disiplinore. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte nga **“vërejtje” deri në “Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”,** përkatësisht për:

1. Për z.T.Xh., me detyrë ish Regjistruer prej v. 1998 deri datë 01.05.1999 për shkeljet trajtuar në **aktverifikimin nr.1, procesverbalet nr.2, nr. 4, nr. 21, dhe trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit.**

2.Për z. A. Xh., me detyrë ish-Regjistruer deri datë 29.11.2013, për shkeljet trajtuar në **aktverifikimin nr.1, procesverbalet nr. 2, nr. 4, nr. 5, nr. 6, nr. 7, nr. 8, nr. 10, nr. 11, nr. 12, nr. 14, nr. 15, nr. 20, nr. 21, nr. 22 dh nr. 23 dhe trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit.**

3.Për znj. Z.P., me detyrë ish specialiste v. 2000-2007, ish-Përgjegjëse e Sektorit të Regjistrimit Fillestar dhe Hartografisë 2007-2012, për shkeljet trajtuar në **procesverbalet nr. 2, nr. 4, nr. 5, nr. 22, dhe trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit.**

4. Për z. E.K., me detyrë ish-Hartograf për periudhën 2009-2014, për shkeljet trajtuar në **procesverbalet nr. 5, nr. 7, nr. 10, nr. 14, nr. 19, nr. 20, nr. 21, dhe trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit.**

5. Për z. Q.P., me detyrë ish-Hartograf deri 22.3.14 (aktualisht specialist në ALUIZN Dibër), për shkeljet trajtuar në **procesverbalet nr. 15, nr. 18, nr. 20, nr. 21, nr. 23 dhe trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit.**

Për punonjësit aktual dhe 5 punonjësit e larguar përcaktuar më sipër masat kërkohen:

-Për moszbatim të kërkesave të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar me ligjin nr. 33/2012 datë 21.3.2012“Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me pikën 1, të UKM nr. 1, datë 31.07.2007 “Për procedurat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme” dhe kapitullin e I, të Udhëzimit të Kryeregjistruesit nr. 2532, datë 21.04.2009 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të fituar me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale” dhe të Rregullores për Punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, nr. 184, datë 08.04.1999 të ndryshuar, si dhe dispozitave të tjera ligjore.

-Për të metat e mangësi të konstatuara, në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor në regjistrimin fillestar e veprimeve të tjera, të pasurive të paluajtshme, sipas trajtimit në procesverbale dhe në kapitujt përkatës të Raportit Përfundimtar të Auditimit të paraqitur për ZVRPP Dibër.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Administrimit Aseteve të Qëndrueshme, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikes.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R